

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie
ndërkombëtare”

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Enri Hide

PHD. Gert Guri

(Korrik/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie ndërkombëtare”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër MASH Nr. 482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër MASH Nr. 291, datë 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Marrëdhënie ndërkombëtare”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për programin e studimit: 2016-2017 2017-2018	29 studentë 33 studentë



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie ndërkombëtare”

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” (UMSH) është licensuar si “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 19.02.2009. Me anë të Urdhërit Nr. 124, 29.03.2012 dhe Urdhërit Nr. 921, 11.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, është realizuar akreditimi institucional dhe i programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë. Me anë të Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 105, datë 10.11.2017, është realizuar akreditimi periodik institucional. Me Urdhërin Nr. 273, datë 18.05.2017, është hapur njësi e re kryesore “Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike” dhe është riorganizuar njësi kryesore nga “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike” në “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare” si dhe me Urdhër Nr. 278, datë 19.05.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar statuti i ri i Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pjesë e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi i studimit është licensuar me Urdhër të MASH Nr. 482, datë 03.10.2011 dhe është akredituar me Urdhër të MASH Nr. 291, datë 11.07.2012.

Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit MND (përgjegjës për programin e studimit)

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Departamenti i të Drejtës Publike
	Departamenti i të Drejtës Civile
	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

- Struktura didaktike (Departamentet) në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare



Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

FAKULTETI I SHKENCAVE JURIDIKE DHE MARREDHENIEVE NDERKOMBETARE

DEKAN

Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI

Departamenti Marrëdhënieve Nderkombetare

Shef Departamenti

PhD. Edon QESARI

GRUP LENDE Teori dhe Histori te
Marrëdhënieve Nderkombetare

PhD (c) Kriton Kuci

PhD (c) Dritan Hoti

Prof. Dr. Paskal Milo

Prof. Asoc. Dr. Bashkim Rama

Prof. ASoc Dr. Arben Cici

GRUP LENDE Studime euromesdhetare dhe
Gjuhe e huaj

Dr. Morena Citozi

Msc. Valbona Lohja

Msc. Era Bucpapa

Msc. Eranda Kociko

Dr. Sokol Dedja

Msc. Klajda Gjoshja

GRUP LENDE Teori dhe Histori Diplomacise

PhD. Nevila Rama

PhD. Edon Qesari

Prof. ASoc Dr. Arben Cici

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vendosën: Prof. As. Enri Hide dhe PhD. Gert Guri, ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Më datë 05.07.2018, përmes sistemit AMS, Institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Mbi Draft-Raportin, Institucioni, është njoftuar edhe me shkresë zyrtare Nr. 87/36 Prot., me lëndë “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”. Më datë 10.07.2018, Institucioni, përmes shkresës zyrtare Nr. 1075 Prot., datë 09.07.2018, me lëndë “Objeksione për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare”, përcjell në ASCAL komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi lexoi me kujdes përgjigjen e IAL-së, vendosi: të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 3 dhe 6; të marrë pjesërisht në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 2; të bëjë një rivlerësim të rubrikës 6 duke ndryshuar konkluzionin për të nga “standardet përmbushen kryesisht” në “standardet përmbushen plotësisht”.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:


- a. Të ndërtohen disa aspekte të punës si “Zyra e Karrierës” dhe “Qendra e Kërkimit Shkencor”.
- b. Të sigurohet produkti konkret krahas marrëveshjeve të realizuara.
- c. Të azhurnohet më mirë me qendra të specializuara të Mesdheut duke azhurnuar me to punën dhe kërkimin shkencor.
- d. Të përmirësohet niveli i gjuhës angleze për studentët e pranuar në këtë program studimi.
- e. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
- f. Të mbajë në vëmendje në vitin e dytë MA praktikën dhe realizimin e tezës në mënyrë sa më serioze.
- g. Të sigurojë në kohën e duhur programet dhe kurrikulën e nivelit të doktoraturës.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a. **Të ndërtohen disa aspekte të punës si “Zyra e Karrierës” dhe “Qendra e Kërkimit Shkencor”.**

Krijimi i Zyrës së Karrierës është një hap pozitiv në lidhje me rekomandimet e ofruara ndërkohë që kjo zyrë mbante lidhjet me studentët në tregun e punës, ofronte mundësi për këta studentë, kryesisht nëpërmjet Alumni. Zyra kishte të dhëna për të punësuarit por ende nuk janë zhvilluar praktika dhe procedura lidhur me rolin e kësaj zyre për punësimin e studentëve. Ndonëse edhe vetë IAL pranon, gjatë vizitës në institucion, se kjo është një zyrë e re, e cila vetëm vitin e fundit kishte filluar funksionimin.

Zyra e Kërkimit Shkencor ishte funksionale dhe në drejtimin e një profesori. Ajo shërbente për të shpërndarë financimin për kërkimin shkencor (kryesisht pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë) si dhe për të “monitoruar” vetëdeklarimin e punës shkencore nga pedagogët (Aneksi A). Ajo është e ndarë praktikisht nga Zyra e Projekteve, që është bërë



funkionale vetëm gjatë 2017-2018, me një sërë aplikimesh (13) dhe disa prej tyre të suksesshme (përfshirë edhe me BE – një Horizont 2020).

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

b. Të sigurohet produkti konkret krahas marrëveshjeve të realizuara.

Shumica e marrëveshjeve të bashkëpunimit të paraqitura nuk kanë lidhje direkte me programin e paraqitur për akreditim ose janë marrëveshje kuadër të cilat nuk ofrojnë një produkt konkret për këtë program studimi. Më poshtë po analizojmë disa pika përpjekje nga ana e Institucionit që gjithsesi nuk arrijnë të përmbushin plotësisht rekomandimin e ofruar:

1. Në marrëveshjet me Bashkitë e Sarandës, Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe nën-bashkinë e Tiranës nuk është e qartë nëse janë ofruar bursa studimi për studentët e marrëdhënies ndërkombëtare nga këto institucione dhe kush mund të jetë për studentët avantazhi i zhvillimit të praktikave pranë këtyre institucioneve. Në takimin me përfaqësues të programit gjatë vizitës në institucion u kërkuan shpjegime dhe ndërsa për dhënien e bursave nuk ka një numër apo dokumentacion të saktë, për praktikën është shpjeguar se ideja është që studentët të njihen jo vetëm me funksionimin e institucioneve qendrore por edhe atyre lokale. Kjo përgjigje do të ishte bindëse në rast se studentët ndërkohë kanë një praktikë të institucionalizuar pranë institucioneve primare për profilin e tyre si p.sh. Ministria e Jashtme, Organizata Ndërkombëtare që operojnë në vend, apo edhe institucione të tjera që funksionojnë në këtë fushë. Jemi të mendimit se këto marrëveshje mund të vlejnjë veçanërisht për degët e tjera të universitetit dhe jo për masterin e marrë në shqyrtim.

2. Marrëveshja me një projekt IPA project që mbaron në vitin 2012 dhe nuk është e qartë nëse është financuar. Për më tepër në marrëveshje nuk ka asnjë referencë ndaj programit apo mundësive të angazhimit të studentëve në këtë projekt. Nuk është e qartë se si është përfshirë universiteti, roli dhe përfundimet pozitive nga kjo eksperiencë. Për studentët, gjatë takimit në institucion, UMSH informon se janë përfshirë në procese të tjera kërkimore dhe në programe Erasmus: megjithëse ka informacion mbi këto programe duhet të ofrohen të dhëna me të sakta mbi numrin e studentëve të përfshirë.

3. Në marrëveshjen me Universitetin Katolik Dimitrie Kantemir, të Tuzlës, me Link Campus University, Rome, me Kolegjin Universitar Biznesi në Prishtinë, VUZF University of Sofia, Lodz University, Eaton Business School, Universita' Lum Jean Monnet, Universiteti i Tiranës, Sigmund Freud University, etj. janë marrëveshje kuadër në të cilat nuk specifikohen fushat akademike të bashkëpunimit ku të përmendet edhe masteri i paraqitur për akreditim, apo ku të nënvizohet ekzistenca e një programi të ngjashëm në këto universitete. Ndërsa, marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Catanias është firmosur për programin specifik të Shkencave të Shërbimeve Sociale dhe jo për masterin e paraqitur për akreditim. Këto marrëveshje janë mjaft të përgjithshme dhe pa një vlerë reale për programin e marrë në shqyrtim. Një marrëveshje e cila mund të dëshmojë një përpjekje në drejtim të rekomandimeve të Këshillit të Akreditimit është ajo me Qendrën CEMAS (Universita' La Sapienza) apo Qendrën për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, të cilat janë të specializuara në fushën e marrëdhënies ndërkombëtare apo të integritimit evropian.

4. Marrëveshja me Universitetin e East Anglia është për dërgimin e studentëve dhe ka një periudhë kohore 2012-2015 por në asnjë rast nuk nënvizohet mundësia e kryerjes së praktikave mësimore apo shkëmbim i studentëve në programin e paraqitur për akreditim, apo në fushat shkencore të mbuluara nga ky program.

5. Janë një sërë institucioneesh në marrëveshje të cilët nuk kuptohet qartë lidhja me programin siç janë: 2 AM Studio; A&A Film Company; IMB për programet e kontabilitetit; ABKONS; Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm; Kontrolli i Lartë i Shtetit, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, A&B Business consulting group; etj. Duhet të sqarohet nëse programi i paraqitur për akreditim ka një specializim apo lëndë të caktuar që i jep mundësinë studentëve të punësohen dhe për rrjedhojë të specializohen në fushat e kompetencave të këtyre institucioneve. Banka Pro-Credins ka një marrëveshje bashkëpunimi të specifikuar por jo për degën në fjalë. Një marrëveshje e cila mund të dëshmojë një përpjekje në drejtim të rekomandimeve të Këshillit të Akreditimit është ajo me qendrën Headhunter në të cilën shprehet në mënyrë të specifikuar gadishmëri për të ndihmuar studentët e UMSH në identifikimin dhe kryerjen e praktikave mësimore pranë institucioneve që përkojnë me objektivat e tyre studimore.

6. Interesante për punësimin është marrëveshja me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë për pjesëmarrjen në panairin e punësimit.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

c. Të azhurnohet më mirë me qendra të specializuara të Mesdheut duke azhurnuar me to punën dhe kërkimin shkencor.

Dokumentet e paraqitura i referohen projektit të bashkëpunimit me Euro-Mediterranean University of Slovenia (EMUNI), i cili është një institucion relativisht i ri (me një eksperiencë vetëm 10-vjeçare) dhe ka një fokus relativisht të kufizuar në bashkëpunimin mesdhetar duke mos përfshirë të gjithë fokusin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesit akademikë të programit gjatë vizitës në institucion mësuam se bashkëpunimi përqëndrohet në dy drejtime: i) në zhvillimin e konferencave të përbashkëta; ii) në shkëmbimet e stafit akademik. Siç përmendëm edhe më lart kur spjeguar marrëveshjet e bashkëpunimit, ka shumë pak syresh të cilat janë lidhur me qendra të cilat funksionojnë në fushën e specializimit të këtij masteri shkencor, ndërkohë që marrëveshjet mbeten kuadër dhe nuk kanë të specifikuar fushat konkrete të bashkëpunimit. Për mendimin tonë, këto rezultate nuk janë plotësisht të mjaftueshme duke konsideruar një program që funksionon për më shumë se 6-vjet dhe pret të ri-akreditohet.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

d. Të përmirësohet niveli i gjuhës angleze për studentët e pranuar në këtë program studimi.

Ofrimi i një lënde në anglisht është një hap shumë pozitiv por më shumë duhet të bëhet në këtë drejtim. Në takimin gjatë vizitës në institucion mësuam nga studentët se ofrimi i një lënde në anglisht ishte pritur mirë.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

e. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Përsa i takon dhënies së provimit të gjuhës angleze, përveç përmbushjes së dispozitave ligjore, ka një hap pozitiv siç është marrëveshja që UMSH ka me STA për mundësinë e studentëve në dhënien e provimit të gjuhës angleze.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

f. Të mbajë në vëmendje në vitin e dytë MA praktikën dhe realizimin e tezës në mënyrë sa më serioze.

Ndonëse është paraqitur dokumentacioni lidhur me standardet e cilësisë së tezës, në spjegimet e dhëna (RVB, fq.7) theksohen bashkëpunimet me institucione dhe organizata të fokusuar në çështjet e integritit evropian dhe mesdhetar. Megjithatë mungon një marrëveshje specifike e lidhur me këto institucione që ti referohet tezës finale, përveç disa marrëveshjeve kuadër me universitete të tjera. Për më tej theksohet veçanërisht integrimi mesdhetar dhe evropian ndërkohë që spektri i një masteri në marrëdhënie ndërkombëtare është shumë më i gjerë se kaq.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

g. Të sigurojë në kohën e duhur programet dhe kurrikulën e nivelit të doktoraturës.

Është planifikuar dhe vërtetuar si nga dokumentacioni ashtu edhe nga takimi i zhvilluar gjatë vizitës në institucion, hapja e programit të doktoraturës në vitin akademik 2018-2019.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshkrimi i objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Sipas objektivave të percaktuara në “Strategjinë e Zhvillimit të Programit” dhe “Strategjinë e IAL-së” qëllimi i mësimdhënies në këtë Master Shkencor është përgatitja e studentëve me dije profesionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare duke ndjekur një metodologji interdisiplinare, si edhe duke përmirësuar praktikën e mësimdhënies bazuar në kërkimin shkencor. Përsa i takon pritshmërive të programit, përveç rritjes së cilësisë mësimore synohet edhe përmirësimi i jetës studentore, diversifikimi i njohurive për të rritur mundësinë e zhvillimit të një karriere profesionale duke u bazuar edhe në bashkëpunimin e mëtejshëm me institucionet publike dhe ato jo-qeveritare. Në këtë dokument theksohen gjithashtu edhe procedurat që

ndiqen për kontrollin e mësimdhënies dhe mësimnxënies apo stimulimin e rritjes së cilësisë nga ana e pedagogëve.

Në strategjinë e zhvillimit theksohen edhe procedurat që janë ngritur për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave (në përputhje me nevojat e tregut të punës) dhe të nivelit të stafit akademik. Për rritjen e nivelit të stafit në periudhën një-vjeçare konsiderohen si hapa të nevojshëm në këtë strategji pjesëmarrja e pedagogëve në projekte ndërkombëtare, forcimi i bashkëpunimit me institucione partnere, si edhe rritja si e cilësisë ashtu edhe e cilësisë së botimeve të pedagogëve. Për realizimin e këtij qëllimi është paraqitur në strategjinë e zhvillimit të programit edhe një procedurë përkatëse, lidhur me përsosjen e procedurave mësimore. Në pritshmëritë aftamesme mund të theksojmë ndryshimin dhe profilizimin e tematikave të programit sipas nevojave të tregut të punës, ristrukturimin e Zyrës së Projekteve dhe nënshkrimin e protokolleve të bashkëpunimit për unifikimin e disa lëndëve me institucione partnere. Për këtë në Strategjinë e Zhvillimit të Programit parashikohet edhe një përmirësim i mëtejshëm i funksionimit të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës.

Në informacionin e ofruar vihet re një profilizim i kënaqshëm i kompetencave dhe njohurive që duhet të zotërojnë studentët në përfundim të këtij Masteri Shkencor dhe kjo përbën një bazë nga ku mund të nisët puna për plotësimin e aspekteve të përmendura më lart.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
 - Nevojat e tregut të punës
 - Strategjia e zhvillimit të programit të studimit
 - Draft Plani Strategjik i Institucionit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Si në shpjegimet e dhëna në RVB ashtu edhe në dokumentat e paraqitura ka një ndërlidhje ndërmjet misionit dhe objektivave e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të programit. Megjithatë informacioni duhet ti referohej më konkretisht programit të marrë në shqyrtim pasi strategjia në disa raste mbetet në linjë dhe sugjerime të përgjithshme.</p> <p>Studimi i paraqitur mbi tregun e punës është një studim i cili i referohet tregut në përgjithësi dhe jo nevojave konkrete për këtë specialitet studentësh.</p> <p>Shpjegimet e ofruara lidhur me përputhjen e programit të studimeve me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit tregojnë përpjekjet e bëra nga institucioni në këtë drejtim por mund të ishte ofruar edhe një ilustrim më konkret lidhur me këtë përputhje.</p> <p>Ndërkohë nuk është ofruar një shpjegim i plotë lidhur me rolin e programit në ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programet e studimit janë përshtatur në përgjithësi me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Megjithatë ilustrimi i kësaj korrespondence nuk është gjithnjë i plotë. Referenca e dhënë nga Institucioni për Aneksin 1 lidhur me objektivat dhe misionin e masterit ka referenca shumë të përgjithshme dhe nuk ka një ndërthurje të vazhdueshme apo spjegim specifik lidhur me programin në fjalë.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përsa i takon përputhjes së programeve të studimeve me aktet ligjore dhe nënligjore referencat janë bindëse dhe është bërë një punë e mirë përgatitore lidhur me kuadrin ligjor. Akreditimi i mëparshëm ka dhënë një ndihmesë në këtë drejtim, por vihet re edhe një kujdes i vazhdueshëm në përmbushjen e kriterëve ligjore. Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Në dokumentat e paraqitura ofrohet Plani Strategjik i UMSH për Zhvillimin dhe përmirësimin e Programeve të Studimeve, i cili ka në fokusin e tij rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe përgatitjes gjithnjë në rritje të pedagogëve. Në planin strategjik, IAL paraqet procedurat dhe planet për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Kështu vlerësohen arritjet në mënyrë periodike nga grupi i punës i cili propozon ndryshimet e nevojshme në program kur objektivat nuk janë arritur, apo krijimi i një fondi të veçantë për të promovuar inovacionin gjatë mësimdhënies.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ofron programe të cilat janë në përputhje me misionin e tij dhe strategjitë afatshkurtra dhe afatmesme të zhvillimit, si edhe një procedurë periodike për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve mësimore. 2. Dokumenti i paraqitur mbi analizën e tregut të punës duhet të ishte më i detajuar dhe më i përditesuar. 3. Përputhja ndërmjet misionit dhe objektivave e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të institucionit dhe programit duhet ti referohej më konkretisht programit të marrë në shqyrtim pasi strategjia në disa raste mbetet në linjë dhe sugjerime të përgjithshme, të cilat nuk ilustrojnë lidhjen e këtij programi me strategjitë dhe objektivat e përgjithshme të institucionit. 4. Referenca e dhënë nga IAL lidhur me objektivat dhe misionin e masterit ka referenca shumë të përgjithshme lidhur me rezultatet që priten të arrihen këto objektiva, hapat që duhen ndërmarrë për këtë qëllim, si edhe nuk ka një ndërthurje të vazhdueshme apo spjegim specifik lidhur me strategjinë që ndiqet në masterin në fjalë për arritjen e këtij misioni. 	

5. Programet e paraqitura ofrohen në përputhje me kërkesat e parashtruara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Standardet plotësohen kryesisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti është njësia kryesore e UMSH dhe ofron programe të studimeve të cikleve Bachelor, Master, Doktoraturë në përputhje me programet e studimeve të miratuara dhe me legjislationin në fuqi. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga tre departamente kryesore: 1) Departamenti i së Drejtës Publike; 2) Departamenti i së Drejtës Civile; 3) Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Fakulteti ofron një seri programesh mësimore në të gjitha nivelet nga Bachelor tek Master Profesional dhe Master Shkencor duke krijuar kështu mundësinë e formimit të njohurive dhe kompetencave jo vetëm nga ana e studentëve por edhe e stafit akademik. Fakulteti ka evoluar në zhvillimin e tij për të përmbushur më mirë nevojat dhe sfidat e parashtruara: kështu nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, sot quhet Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.


Fakulteti ofron 2 programe studimi Bachelor, 3 programe të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe 1 program të ciklit të dytë Master Profesional dhe ka aktualisht 37 pedagogë nga të cilët 26 janë me kohë të plotë dhe 11 prej tyre janë me kohë të pjesshme.

Departamenti është njësia bazë e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për secilin nga programet akademike dhe roli i tij është jo vetëm të stimulojë dhe bashkërendojë mësimdhënien në nivelet e ndryshme të programeve që ofron, por edhe të bashkërendojë punën në drejtim të kërkimit akademik. Departamenti propozon drejtimet strategjike dhe ndryshimet përkatëse përsa i takon kurrikulave, përcakton programet si edhe evidenton nevojat për staf akademik pranë dekanit të fakultetit dhe rektorit të universitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit

Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion, konstatohet se strukturat akademike të fakultetit janë të organizuara në përputhje me misionin e tij. Fakulteti ka një staf të përbërë nga 73 persona prej të cilëve 37 janë personel akademik ndërsa 36 janë personel administrativ. Numri më i lartë i PAE si nga numri në total ashtu edhe nga numri i PAE me gradë shkencore i



përket Departamentit të së Drejtës Publike, ndërkohë që numri i PA është i barabartë (12) për çdo departament.

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare është i organizuar në tre grup-lëndësh kryesore: a) Teoritë dhe Historitë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare; b) Studime Euro-Mesdhetare dhe Gjuhë e Huaj; c) Teori dhe Histori e Diplomacisë. Ndërtimi i grupeve pranë Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është strukturalisht i ekuilibruar. Megjithatë prezenca e një grupi dedikuar shkencave politike, institucioneve ndërkombëtare (duke patur porsysh përgatitjen e kadrove për integrimin e Shqipërisë si një nga misionet kryesore të këtij programi) dhe ekonomisë ndërkombëtare do të krijonte një shpërndarje më të plotë të njohurive akademike dhe punës shkencore në këto drejtime.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Vihet re (Tabelat 1 dhe 2 në Aneks) një numër i kënaqshëm pedagogësh (13) pranë Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ndonëse nga 8 PAE vetëm më pak se gjysma e tyre (3) janë me gradën shkencore PhD/Doktor ndërsa pjesa tjetër janë raportuar (Tabela 2 në Aneks) pa tituj dhe grada. Duke qenë se dy prej tyre janë në procesin e marrjes së doktoraturës (kandidatë) dhe tre të tjerë janë në nivel master mund të krijohet një vakum nga ana akademike lidhur me cilësinë si të mësimdhënies ashtu edhe të kërkimit shkencor pranë departamentit. Ndërkohë, për pedagogët me kohë të pjesshme ky numër është shumë më pozitiv: nga 5 pedagogë 4 prej tyre kanë grada shkencore dhe tituj akademikë, ku 1 është Profesor, 2 të tjerë janë Profesorë të Asociuar dhe 2 gradën shkencore Doktor. Ky fakt mund të kompensojë deri në njëfarë mase numrin e ulët të titujve shkencorë tek PAE por përsëri PAK kanë më pak detyrime institucionale, kohë dhe pjesëmarrje në aktivitetet e departamentit prandaj kjo sfidë duhet të shihet me kujdes në të ardhmen. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka numrin më të ulët si të PAE në total (krahasuar me departamentet e tjera të këtij fakulteti) ashtu edhe përsa i takon PAE të cilët kanë grada shkencore.

Përsa i takon pedagogëve të Departamentit, raporti është 8 PAE/5 PAK për vitin 2017-2018 dhe 8 PAE/2 PAK për vitin akademik 2016-2017. Në vitin akademik 2017-2018 kemi 3 PAE me gradën Doktor, 2 PAE në procesin e marrjes së kësaj grade dhe 3 PAE me Master. Ndërsa PAK paraqitet me një nivel më të lartë gradash. Kështu kemi 1 PAK me titullin Profesor, 2 PAK me titullin Prof.As, 1 PAK me gradën Doktor dhe 1 PAK me Msc. Në vitin akademik 2016-2017 përbërja e PAE në lidhje me gradat paraqitet e ndryshme me atë të vitit 2017-2018: kështu janë 4 PAE me gradën Doktor, 1 PAE në procesin e marrjes së gradës Doktor dhe 3 PAE me Master. Ndërsa përsa i takon PAK të dy kanë titullin e Profesorit të Asociuar. Sikundër shihet në vitet e fundit kemi një rritje si në numër ashtu edhe në cilësi të PAK ndërsa përsa i takon PAE numri nuk ka ndryshuar ndërsa cilësinë akademike e stafit ka pësuar një rritje të lehtë. Janë ofruar pranë programit si pedagogë të jashtëm edhe lektorë të cilët si nga eksperiencat e punës që kanë kryer apo kryejnë akoma mund të sjellin jo vetëm njohuri akademike por edhe përvoja praktike duke e pasuruar dhe bërë më interesant programin.

CV e paraqitura nga ana e pedagogëve duhen rifreskuar. Për shembull CV e paraqitur nga Përgjegjësi i Departamentit PhD. Edon Qesari i referohet akoma periudhës kur punonte në një tjetër Institucion (Instituti Shqiptar i Marrëdhënieve Ndërkombëtare) dhe nuk është rifreskuar. Ky është ndoshta edhe fakti që në CV mungojnë botimet akademike në përputhje me fokusin e departamentit që drejton.

Më tej mendojmë se Tabela 2 e RVB-së me të dhënat për pedagogët e jashtëm duhet rifreskuar pasi ka disa mos-përputhje: në të thuhet për shembull se institucioni ku punon Prof. Dr. Paskal Milo është Kuvendi i Shqipërisë ndërkohë që një gjë e tillë nuk është pasqyruar në CV e paraqitur prej tij ku rezulton si ligjërues pranë Universitetit të Tiranës.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Listë Staf Administrativ, Senati Akademik, Bordi i Administrimit dhe funksione të tjera.
 - Stafi i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në dy vitet e fundit

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje disa fakultete (dhe departamentet përkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një masteri inter-disiplinar, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit përkatës por edhe nga fakultetet e tjera (siç mund të jetë Fakulteti Ekonomik).</p> <p>UMSH është i organizuar në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Ndërkombëtare, si edhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike duke përmbushur kështu dispozitat ligjore.</p> <p>Secili nga fakultetet është i organizuar në njësi bazë departamente dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Ndërkombëtare ka tre të tilla: Departamenti i së Drejtës Publike, Departamenti i së Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Nuk mund të gjykojmë nëse të tre departamentet kanë objektiva dhe misione të mirë-përcaktuara pasi prezantimi i tyre në dokumentacionin e paraqitur nuk është i qartë.</p>
	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërjen e tij 8 anëtarë efektivë nga të cilët 3 mbajnë gradën shkencore PhD/Dr ndërsa dy të tjerë janë në proces për marrjen e gradës Doktor.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Në informacionin e paraqitur në “Rregulloren e Programit të Masterit të Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare” përshkruhen</p>

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

procedurat dhe mekanizmat që janë vendosur për të siguruar realizimin e programeve të studimit, kontrollin e cilësisë. Procedurat të cilat sigurojnë realizimin e programeve janë p.sh. ballafaqime periodike me studentët, organizimi i më shumë se një pyetësori me studentët në fazën fillestare të zbatimit të programit, frekuenca me të cilën ripërtërihen programet mësimore, etj.
Në rregulloren e UMSH, shprehen dhe përcaktohen në mënyrë të qartë procedura se si njësitë bazë përfshihen në procesin e rekrutimit akademik. Kështu propozimi mbi nevojat e stafit akademik bëhen nga ana e departamentit, stafi i të cilit merr pjesë edhe në përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Struktura e ndërtimit të UMSH në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti, është bërë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.
2. Numri i pedagogëve në nivel departamenti është bërë konform kuadrit ligjor si përsa i takon numrit ashtu edhe nivelit akademik.

Standardet plotësohen plotësisht.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i programit, për vitin akademik 2017-2018, përbëhet nga 15 pedagogë, 10 prej të cilëve janë PAE dhe 5 prej tyre janë PAK. Raporti në program është 2 PAE për 1 PAK përsa i takon numrit ndërsa përsa i takon ngarkesës në program është 73% PAE dhe 27% PAK. Lidhur me kualifikimin e stafit, stafi PAE paraqitet si vijon: 1 PAE në program mban titullin Prof. Dr, 6 PAE mbajnë gradën PhD/Dr, 2 PAE janë në procesin e marrjes së gradës shkencore Dr., dhe 1 PAE është me Msc. Stafi PAK paraqitet si vijon: 1 PAK me titullin Prof. Dr, 3 PAK me titullin Prof. As dhe 1 PAK me Msc. Përsa i takon raportit midis femrave dhe meshkujve vihet re një lloj njëanshmërie duke qenë se në nivelet e Profesorit dhe Profesorit të Asociuar nuk ka asnjë femër ndërsa në nivelin e Doktoratës ky raport është 4/2 në favor të pedagogëve femra. Një tjetër aspekt që meriton vëmendje, i cili është sqaruar më në detaje në seksionin përkatës, është edhe ai i shpërndarjes moshore e cila është përqendruar kryesisht në moshën 35-

45 për gradën doktor dhe për moshën mbi 66 vjeç për gradën profesor. Ndërkohë që në nivel departamenti janë 12 punonjës administrativë, të cilët kontribuojnë në mbarëvajtjen e programit.

Ka një numër të lartë pedagogësh për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program dhe për ngarkesën që këta pedagogë dedikojnë në programin e paraqitur për akreditim. Kjo shpërndarje harmonike e ngarkesës vihet re si përsa i takon mësimdhënies ashtu edhe praktikave mësimore dhe ndjekjes së punës për përfundimin e tezës së masterit.

Ngarkesa e stafit akademik i cili merr pjesë në programin është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në shumë raste edhe nivele mjaft të mira përsa i takon orëve mësimore, duke marrë këtu parasysh edhe ngarkesën akademike që ata mund të kenë në programe të tjera të IAL. Kështu pjesa më e madhe e PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë më të ulët se 200 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme prej 195 orësh çka i krijon mundësinë që të mbulojë edhe aspektet administrative dhe kërkimore të pozicionit. Po kështu edhe ngarkesa e PAK është më pak se një ngarkesë e plotë mësimore dhe PAK të cilët mbajnë gradën Prof. Si për shembull Prof. Dr. Paskal Milo ka një ngarkesë prej 75 orësh apo Prof. As. Bashkim Rama dhe Prof. As. Arben Cici kanë një ngarkesë respektive prej 150 dhe 105 orësh mësimore.

Përsa i takon përputhjes mes personelit akademik dhe kualifikimit në disa raste vërehet një mospërputhje ndërmjet fushës së specializimit të pedagogut dhe lëndës që ofrohet. Kjo është më e dukshme në rastin e PAE ndërsa përzgjedhja e pedagogëve PAK është në një nivel të kënaqshëm si përsa i takon kualifikimit ashtu edhe profilizimit për tematikat që mbulon. P.sh. Z. Ilir Aliaj është pedagog i lëndës së “Krizave Ndërkombëtare dhe Zgjidhjes Paqësore të Tyre” si edhe bashkë-lektor në lëndën e “Institucioneve dhe Administratës së BE”, ndërsa në CV e paraqitur nuk dalin qartë publikimet apo specializimet të cilat mund të ilustronin kompetencat në fushën akademike të Krizave Ndërkombëtare (ndërkohë që ka një përputhje të kënaqshme ndërmjet temës së doktoraturës dhe lëndës mbi Insitucionet e BE-së). Një tjetër rast është ai i pedagoges Morena Citozi e cila ka një doktoraturë në anglisht dhe është lektore e lëndës së “International Relations”. Në CV e paraqitur nuk dalin qartë as edukimi, as specializimi dhe as publikimet, të cilat mund të ilustrojnë dhënien e një lënde kaq të rëndësishme për vetë programin siç është “International Relations”, ndonëse njohuritë e saj në anglisht janë të domosdoshme për dhënien e kësaj lënde në gjuhën angleze (sikundër është parashtruar në programin mësimor).

Në informacionin e paraqitur në RVB dhe në anekset përkatëse, nuk është respektuar plotësisht standardi në raportin e numrit të PAE dhe PAK të cilët janë angazhuar pranë programit akademik i cili është 67%/33%, ndërsa ky raport është më pozitiv në nivelin e mësimdhënies ku PAE mbulojnë 73% të programit ndërsa PAK 27% të tij.

Niveli i raportit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve është relativisht i kënaqshëm ndërsa përsa i takon stafit administrativ mund të konsiderojmë në analizë stafin administrativ dhe atë ndihmës në nivel departamenti. Stafi ndihmës mbështet pedagogët dhe studentët duke u përqëndruar kryesisht në dy aspekte kryesore: ndihma administrative e cila lidhet kryesisht me aspektet proceduriale dhe ndihma për mbështetjen e aspekteve mësimore siç janë IT (interneti dhe funksionimi i aparaturave audiovizive gjatë leksionit), arkiva, shërbimet e informacionit online apo edhe sistemi i bibliotekës.

Megjithatë ka një shpërndarje moshash jo të njëtrajtshme të moshave në stafin akademik PAE i cili është angazhuar pranë këtij programi. Ka një mungesë të theksuar të brezit të mesëm i cili do të kishte rolin e tranzicionit ndërmjet dy grup-moshave kryesore: profesorit të programit mbi 66 vjeç, dhe pjesës tjetër të stafit akademik me moshën mesatare 25-35 (2 PhD/Dr), dhe 36-45 vjeç (2 PhD/Dr) dhe 46-55 vjeç (1 PhD/Dr). Kjo mospërputhje do të krijojë, në rast se nuk zgjidhet, një problem në zhvillimin afatmesëm të programit dhe në përmirësimin e kurrikulave të tij. Përsa i takon PAK vërejmë një shpërndarje moshash si më poshtë: 25-35 vjeç (1 Msc), 36-45 vjeç (1 Prof. As), 46-55 vjeç (1 Prof. As) dhe 66-68 vjeç (1 Profesor dhe 1 Prof. As).

Kriteret e punësimit të personelit akademik janë kryer në përputhje me normat dhe dispozitat ligjore si dhe ka një përshkrim të qartë të detyrimeve të palëve gjatë zhvillimit të procesit kontraktual. Në dokumentacionin e paraqitur nga IAL në dokumentin me titull “Kontrata e Punës” janë paraqitur dy tipologji të veçanta kontratash për personelin PAE dhe PAK. Kjo edhe duke patur parasysh profilet, kërkesat dhe angazhimin e ndryshëm të këtyre dy figurave pranë Institucionit.


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Në Tabelat 3 (*shiko Aneks*) prezantohet numri dhe gradat e pedagogëve të angazhuar në programin Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare për vitin akademik 2017-2018 dhe për vitet e tjera që prej akreditimit të parë të këtij programi studimi. Personeli akademik i programit, për vitin akademik 2017-2018, përbëhet nga 10 PAE dhe 5 PAK. Megjithëse në një shkallë të vogël ka një mungesë balance, përsa i përket aspektit ligjor (70%/30%) ndërmjet pedagogëve të brendshëm 67% dhe atyre të jashtëm 33%, përsa i përket mbulimit të ngarkesës, raporti është 73% PAE dhe 27% PAK. 1 PAE në program mban titullin e Profesorit, 6 PAE mbajnë gradën PhD/Dr, 2 PAE janë në procesin e marrjes së gradës Doktor i Shkencave, ndërsa 1 prej tyre është me Msc. PAK ka 1 Prof. Dr, 3 Profesorë të Asociuar dhe 1 Msc. Më tej vihet re një mungesë e titujve profesorë në PAE e institucionit ndërsa tre Profesorë të Asociuar dhe një Profesor janë PAK. Ndonëse raporti në nivelin profesor ndërmjet PAE/PAK është 1/1, duke konsultuar programin shikojmë se profesori PAE është i angazhuar pjesërisht vetëm në një lëndë dhe nuk është pjesë e stafit akademik të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare ashtu sikundër edhe profesori PAK është vetëm bashkë-autor në një lëndë. Kjo mund të ulë rolin pozitiv që këta pedagogë mund të luajnë efektivisht në mbarëvajtjen e programit dhe mund të krijojë vështirësi në menaxhimin akademik dhe qëndrueshmërinë e programit me burimet e brendshme për periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme.

Kjo pasqyrë ndër vitet e akreditimit duke u nisur nga viti akademik 2012-2013 është si vijon:

1. Për vitin akademik 2016-2017 raporti i numrit PAE/PAK është 8/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Prof. As, 4 PhD/Dr., 2 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa PAK janë 4 Prof. As. Përsa i takon raportit të mësimdhënies është 70% PAE dhe 30% PAK.
2. Për vitin akademik 2015-2016 raporti i numrit PAE/PAK është 7/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 3 PhD/Dr., 3 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 3 Prof. As. dhe 1 Ambasador.



3. Për vitin akademik 2014-2015 raporti i numrit PAE/PAK është 8/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 1 Prof.Dr, 2 PhD/Dr. , 1 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 2 Prof. As., 1 PhD/Dr. dhe 1 Ambasador.
4. Për vitin akademik 2013-2014 raporti i numrit PAE/PAK është 9/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 3 PhD/Dr. 3 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 1 Prof., 1 PhD/Dr. dhe 2 Ambasadorë.
5. Për vitin akademik 2012-2013 raporti i numrit PAE/PAK është 8/5. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 1 Prof., 1 Prof.As., 3 PhD/Dr., 1 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 1 Prof.Dr, 2 PhD/Dr., dhe 2 Ambasadorë.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Në Tabelën 4 (*shiko Aneks*) janë paraqitur anëtarët e Këshillit Shkencor në të cilët ndoshta do të ishte më e përshtatshme ofrimi i personaliteteve të kësaj fushe. Këshilli Shkencor është instanca e cila mund të ofrojë këshillime dhe sugjerime mbi programin e paraqitur përveçse është përgjegjësi kryesor për cilësinë akademike të programit. Megjithatë në këtë program kjo nuk është patur tërësisht parasysh. Kështu, Kryetarja e Këshillit Shkencor, Prof. As Alketa Elezi, ka një profil juridik dhe është e specializuar në të drejtën penale dhe të drejtën e procedurës penale. Të njëjtin profil ka edhe anëtari tjetër i Këshillit Shkencor Prof. As. Kosta Elezi. Anëtari i vetëm i specializuar në Këshillin Shkencor përsa i takon Marrëdhënieve Ndërkombëtare është PhD. Edon Qesari, i cili ndonëse ka një titull doktorature në Historinë Politike dhe Sociale Bashkëkohore, ka një titull masteri në Studimet Ndërkombëtare.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Stafi akademik mbulon në një nivel të kënaqshëm nevojat e programit përsa i takon ngarkesës së orëve dhe harmonizimit të tematikave të ofruara nga PAE dhe PAK. Sikundër është shpjeguar edhe më lart, kemi një numër prej 10 PAE dhe 5 PAK të cilët marrin pjesë në program ndonëse pedagogët PAK mbeten më të avancuar përsa i takon nivelit të titujve dhe gradave akademike. Në PAE mungon një brez pedagogësh të brezit të ndërmjetëm midis titullit Profesor dhe Doktor Shkencash, çka do të përbente një problem në planin aftagjatë sepse do të krijonte një tranzicion brezash dhe ekspertize dhe do ta linte këtë segment (moshor dhe ekspertize) për t'u mbuluar nga PAK, të cilët mund të mos sigurojnë të njëjtën qëndrueshmëri dhe investim aftagjatë në program si PAE.

Kjo pasqyrë ndër vitet e akreditimit duke u nisur nga viti akademik 2012-2018 është si vijon:

1. Për vitin akademik 2017-2018 raporti i numrit PAE/PAK është 10/5. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor, 6 PhD/ Dr., 2 PAE në procesin e marrjes së gradës PhD/Dr. dhe 1 Msc. Ndërsa PAK janë: 1 Profesor, 3 Prof.As., dhe 1 Msc. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë Doktor Shkencash dhe kandidatë për të marrë këtë titull 80%, por një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm si në numër ashtu edhe në cilësi pasi janë shtuar 1 Profesor dhe 2 PhD/Dr. Ndërsa për PAK mbulohen pothuajse të gjitha gradat përfshirë edhe titullin Profesor (ndërkohë që janë 3 Profesorë

të Asociuar) dhe 1 Msc, çka është një rritje si sasiore si cilësore në krahasim me vitin e mëparshëm.

2. Për vitin akademik 2016-2017 raporti i numrit PAE/PAK është 8/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Prof. As, 4 PhD/Dr., 2 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa PAK janë: 4 Prof. As. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë Doktor Shkencash ose në procesin e marrjes së këtij titulli 75%, por një balancim më të mirë në krahasim me vitin e mëparshëm. Ndërsa për PAK mbulohet vetëm grada Profesori i Asociuar.
3. Për vitin akademik 2015-2016 raporti i numrit PAE/PAK është 7/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 3 PhD/Dr., 3 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 3 Prof.As. dhe 1 Ambasador. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë PhD/Dr. ose në procesin e marrjes së kësaj grade 85% por një ulje të nivelit të gradave pasi 1 PAE me titullin Profesor është zëvendësuar me 1 PAE me Msc. Ndërsa për PAK mbulohet vetem grada Profesor i Asociuar dhe Ambasador.
4. Për vitin akademik 2014-2015 raporti i numrit PAE/PAK është 8/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 1 Prof.Dr, 3 PhD/Dr. , 3 PhD/Dr në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 2 Prof. As., 1 PhD/Dr. dhe 1 Ambasador. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë PhD/Dr. ose në procesin e marrjes së kësaj grade, rreth 75%, dhe një nivel më të ulët të gradave në krahasim me vitin e mëparshëm. Ndërsa për PAK mbulohen të gjitha gradat, me përjashtim të titullit Profesor.
5. Për vitin akademik 2013-2014 raporti i numrit PAE/PAK është 9/4. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor, 1 Prof. i Asociuar, 3 PhD/Dr., 3 PhD/Dr. në proces dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë: 1 Prof., 1 PhD/Dr. dhe 2 Ambasadorë.
6. Për vitin akademik 2012-2013 raporti i numrit PAE/PAK është 8/5. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesorë, 1 Prof.As, 3 PhD/Dr., 2 PAE janë në procesin e përfundimit të PhD/Dr. dhe 1 Msc. Ndërsa për PAK janë 1 Profesor, 2 PhD/Dr. dhe 2 Ambasadorë.

Të dhënat sipas seksit

Përsa i takon raportit midis femrave dhe meshkujve vihet re një lloj njëanshmërie duke qenë se në nivelet e larta akademike (profesor apo profesor i asociuar) ka vetëm pedagogë meshkuj (5 syresh), ndërkohë që në nivelin e doktoraturës ka më shumë pedagoge femra (ky raport është 4/2 në favor të pedagoqeve femra). Në numrin e përgjithshëm duke konsideruar edhe stafin ndihmës akademik me gradën Msc. raporti midis femrave dhe meshkujve është 9/6 në favor të meshkujve. Por siç shihet edhe në tabelën 4, mbetet një mungesë ekuilibri përsa i takon akademikëve më të lartë në gradë ndërmjet femrave dhe meshkujve si në nivelin profesor ashtu edhe profesor i asociuar. Kjo mungesë ekuilibri mund të jetë më e balancuar në të ardhmen duke konsideruar se raporti i femrave në nivelin e Dr/PhD është 4:2 dhe mbështetjen e institucionit në këtë drejtim.

Të dhëna sipas moshës së personelit



Një tjetër aspekt që meriton vëmendje është edhe ai i shpërndarjes moshore e cila është përqendruar kryesisht në moshën 35-45 për gradën Doktor dhe për moshën mbi 66 vjeç për titullin Profesor, një tendencë e cila vihet re veçanërisht tek PAE. Kështu tek PAE kemi pedagogë me gradën Doktor: 2 në grup-moshën 25-35 vjeç dhe 2 në grup-moshën 35-45 vjeç, dhe 1 në moshën 46-55 vjeç, ndërsa kemi vetëm 1 Profesor në grup-moshën 66-68 vjeç. 2 PAE në proces të përfundimit të doktoraturës i përkasin grup-moshës 35-45 vjeç. Ndërkohë në PAK kemi një shpërndarje më lineare ndonëse me një tendencë moshe në rritje. Kështu kemi 1 MSc në grup-moshën 35-45, 1 Profesor të Asociuar për secilën grup-moshë 36-45 vjeç, 46-55 vjeç dhe 56-65 vjeç. Edhe në rastin e PAK i vetmi Profesor i përket grup-moshës 66-68 vjeç. Edhe në tabelën 5 del i qartë problemi i mungesës së brezit të tranzicionit si nga titujt shkencorë ashtu edhe nga eksperiencia. Kështu ka një vakum gati 25 vjecar ndërmjet dy brezave për PAE (nga 45-68 vjeç). Kjo mund të shkaktojë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme mungesën e stafit të nevojshëm akademik pasi brezi i parë do të jetë tërhequr ndërsa brezi i ri nuk do të jetë akoma në nivelin akademik për të plotësuar këtë mungesë. Me përjashtim të PAK nuk ka në PAE një tranzicion ndërmjet titullit Profesor dhe atij Doktor Shkencash. Gjatë vizitës në Institucion nuk ishte e mundur të merrej një përgjigje e saktë lidhur me këtë pyetje.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në aneksin e kontratave të paraqitura vihet re një tipologji e veçantë kontrate kur kemi të bëjmë me PAE apo PAK, të cilat për vetë natyrën e tyre duhet të kenë karakteristika të veçanta duke filluar nga periudha e provës deri tek nevoja a ripërtëritjes vjetore të saj. Megjithatë në informacionin e paraqitur në RVB, ka një paqartësi ku shkruhet për kontratat, citojmë: *“Punonjësit akademikë merren në punë me kontrata të përcaktuara jo më shumë se një vit të përsëritshme”*. Besojmë se kjo kontratë i referohet personelit PAK dhe jo atij PAE pasi për të dytët ripërtëritja vjetore e kontratës nuk do të krijonte horizontin e nevojshëm të sigurisë tek pedagogët PAE për të investuar në planin afatgjatë të zhvillimit akademik të institucionit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ dhe ai ndihmës është i ndarë nga stafi akademik në njësi të caktuara që operojnë në funksione administrative dhe ndihmëse (si për pedagogët ashtu edhe studentët) dhe është i organizuar në disa nivele. Në nivelin administrativ, çdo fakultet dhe departament kanë administratorët përkatës. Funksionon gjithashtu edhe zyra e Këshillimit të Studentëve dhe të Karrierës, e cila bashkëpunon me një staf-ndihmës pranë çdo departamenti për të koordinuar punën lidhur me nevojat e studentëve. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është një tjetër strukturë brenda IAL, që fokusohet kryesisht në programet ndërkombëtare dhe së bashku me Zyrën e Projekteve mbështet pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve në këto programe. Zyra e IT mbulon kryesisht infrastrukturën e IAL por edhe ndihmon në mbarëvajtjen e leksioneve (prezantimet, modulet IT brenda programit etj). Pedagogët dhe studentët kanë edhe ndihmën e Sekretarisë së Pranimit por edhe Sekretarisë Mësimore pranë çdo fakulteti. Strukturat ndihmëse ofrojnë gjithashtu mundësinë për studentët për të marrë pjesë në internship të organizuara pranë këtyre strukturave.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Përmbledhje e procedurës së rekrutimit



- CV e Klajda Gjoshja dhe Kriton Kuci
- Angazhimet dhe ngarkesa e stafit në këtë program dhe programe të tjera
- Stafi i programit i angazhuar ndër vite


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Përsa i takon angazhimit të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në përputhje me objektivat e programeve është i qartë dhe i matshëm angazhimi i personelit ndihmës dhe administrativ, në sajë të informacionit mbi aktivitetet që ato mbulojnë.</p> <p>Përsa i takon personelit akademik zhvillohen procedura përkatëse për matjen e kësaj përpuethshmërie siç janë vlerësimi i punës së stafit në lidhje me objektivat e programit të vlerësimeve. Një model i tillë vlerësimi u pa edhe gjatë vizitës në institucion në dosjet e pedagogëve.</p> <p>Në rregulloren dhe statutin e UMSH parashikohen detyrimet dhe angazhimet e stafit mësimor-shkencor dhe atij administrativ në lidhje me zbatimin e strategjisë së zhvillimit. Roli i stafit ndihmës si p.sh. IT, sekretaria mësimore, arkiva dhe administrata siç u theksua më lart fokusohet në mbarëvajtjen e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe kërkimor të studentëve dhe pedagogëve. Ndërkohë, performanca e pedagogëve vlerësohet në bazë të strategjive të institucionit çka siguron këtë bashkërendim.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Informacioni sqarues lidhur me rolin e personelit akademik në hartimin e kurrikulave përshkruhet në procedurat e hartimit të programit, apo vlerësimit të ndryshimit të programeve kur është e nevojshme. Jepet një përshkrim i qartë i procesit të pjesëmarrjes të pedagogëve në hartimin e kurrikulës duke filluar me konsultime brenda departamentit, ashtu siç edhe u sqaruar gjatë takimit me ekipin akademik të programit gjatë vizitës në</p>

	<p>institucion. Nuk ka një informacion lidhur me pjesëmarrjen në vendimet institucionale, ndonëse në rregulloren e UMSH përshkruhet bashkëpunimi ndërmjet strukturave menaxheriale dhe atyre akademike.</p> <p>Rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me normat ligjore, duke u nisur nga evidentimi i nevojës për personel brenda departamentit. Një pasqyrë më e plotë e këtij informacioni është paraqitur edhe në dokumentin përkatës: "Përmbledhje e procedurës së rekrutimit" ofruar gjatë vizitës në institucion. Orët e ngarkesës sikundër është shpjeguar edhe në pjesën përshkrimore janë në përputhje me gradën akademike të pedagogut dhe në shumicën e rasteve më pak se norma e parashikuar për universitetet publike.</p>
--	---

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Procedura e rekrutimit është në përshtatje me aktet ligjore dhe me rregulloret (neni 38, 39, 40) dhe me statutin e institucionit. Procedura e rekrutimit nis me evidentimin e nevojës nga ana e shefit të departamentit, e cila i përcillet dekanit dhe më pas rektorit për aprovim. Më pas bëhet publikimi i këtij pozicioni në faqen e internetit dhe testimi i kandidatëve, përzgjedhja e të cilëve kalon në dy faza: shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistimi i kandidatëve të përzgjedhur nga faza e parë nga një komision i posaçëm ku bën pjesë edhe përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Siç është përmendur edhe në pjesën përshkrimore, në RVB, është paraqitur një numër PAE prej 10 pedagogësh dhe PAK prej 5 pedagogësh në program në një raport 67% PAE dhe 33% PAK. Përsa i takon ngarkesës mësimore PAK mbulojnë 27% të ngarkesës ose 360 orë në auditor ndërsa PAE mbulojnë 73 % ose 975 orë në auditor.</p> <p>2016-2017: Raporti PAE/PAK në numër stafi është: 66.7 % PAE dhe 33.3 % PAK.</p> <p>Përsa i takon raportit të mësimdhënies është 70% PAE dhe 30% PAK. Përsa i takon ngarkesës mësimore PAK mbulojnë 30% të ngarkesës ose 405 orë në auditor ndërsa PAE mbulojnë 70% ose 930 orë në auditor.</p>
---	--



	<p>2015-2016: Raporti PAE/PAK në numër stafi është: 63.6 % PAE dhe 36.4 % PAK.</p> <p>2014-2015: Raporti PAE/PAK në numër stafi është: 66.7 % PAE dhe 33.3 % PAK.</p> <p>2013-2014: Raporti PAE/PAK në numër stafi është: 69.2 % PAE dhe 30.8 % PAK.</p> <p>2012-2013: Raporti PAE/PAK në numër stafi është: 61.5 % PAE dhe 38.5 % PAK.</p> <p>Procedura e rekrutimit të personelit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e IAL, e cila është edhe përgjegjëse për mbajtjen e një baze të dhënash me raportet e rekrutimit të personelit, administrimin e informacionit dhe njoftimet për vendet vakante të ofruara nga IAL.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i departamentit ku mbështetet programi PhD. Edon Qesari ka gradën shkencore PhD pranë një institucioni ndërkombëtar por në CV e paraqitur nuk del qartë një përvojë akademike pranë universiteteve perëndimore dhe botime pranë organeve akademike ndërkombëtare në këtë fushë.

Pas konsultimit të CV të pedagogëve të programit mund të themi se të gjithë titullarët e lëndëve kanë gradën akademike “Doktor” ndonëse në disa raste siç janë përmendur edhe në pjesën përshkrimore nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis profilit të tyre akademik dhe lëndës për të cilën janë titullarët.

Në UMSH, Rektori, Zv.Rektori, Dekani, Zv.Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe i programit, si edhe ai i shërbimit janë të punësuar me kohë të plotë pranë këtij institucioni.

Lidhur me mbikëqyrjen e praktikave profesionale në Nenin 26 të Rregullores së Departamentit përcaktohen të gjitha procedurat e brendshme në bazë të së cilës pedagogët e departamentit duhet të sigurojnë mbulimin e të gjithë studentëve në praktikë. Edhe gjatë takimit me stafin akademik gjatë vizitës në institucion u informuam se personeli akademik është i mjaftueshëm për këtë mbikëqyrje, duke patur parasysh raportin ndërmjet studentëve praktikantë dhe pedagogëve të programit.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Përsa i takon përzgjedhjes së temës së tezës Departamenti ofron çdo vit fusha të caktuara nga ku mund të përzgjidhen tematikat e tezave. Gjatë takimit me stafin akademik, gjatë vizitës në UMSH, u informuam se studentëve u ofrohen tematika brenda lëndëve që zhvillojnë, duke patur parasysh interesin e tyre për tematika të veçanta. Në bazë të tematikave dhe profilizimit të pedagogëve, studentëve u përcaktohet pedagogu, i cili do ti ndjekë në hartimin e tezës. Pra zgjedhin tema (për rrjedhojë dhe lëndën brenda të cilës ofrohet ajo dhe pedagogun/en përkatës/e). Ndarja e temave bëhet me miratimin e departamentit apo të më shumë departamenteve në rast se tema është interdisiplinare.</p> <p>Në Aneksin “Udhëzim i Temës së Diplomës për Programin e Ciklit të Dytë” përcaktohet qartë se udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Në këtë udhëzim përcaktohen kriteret e vlerësimit dhe procedurat që duhet të ndiqen gjatë shkrimit të tezës.</p> <p>Përsa i përket kriterit se pedagogu nuk mund të ndjekë më gjatë shkrimit të tezës më shumë se 10 studentë njëkohësisht në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore dhe humane, megjithëse nuk është përcaktuar në dokumentin “Udhëzim i Temës së Diplomës për Programin e Ciklit të Dytë” mendojmë se plotësohet po të kemi parasysh numrin e lartë të pedagogëve në raport me numrin e studentëve.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është</p>	<p>Në bazë të dokumentit “Udhëzim i Temës së Diplomës për Programin e Ciklit të Dytë”, fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Edhe gjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me stafin akademik, mësuam se pasi studenti zgjedh temën i caktohet si udhëheqës</p>

parashikuar të hartohet teza.	pedagogu me profilin përkatës në atë temë. Në Aneksin 8 të RVB citojmë: “Udhëzim për Punimin e Temës së Diplomës për Programin e Ciklit të Dytë”, nuk ka një referencë specifike lidhur me njohuritë e avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën e studimeve në të cilën është parashikuar të hartohet teza, ndonëse kushtëzimi që pedagogu duhet të përzgjidhet nga fusha përkatëse mund të sigurojë rezultat të njëjtë.
-------------------------------	--

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatoam se sallat e mësimi ishin përgjithësisht në gjendje optimale dhe të mirëmbajtura, ndërsa personeli ndihmës i mjaftueshëm sidomos përsa i takon ndihmës për mbarëvajtjen e procesit mësimor (materiale online, mjetet audiovizive dhe IT).</p> <p>Në dokumentin “Lista e Stafit Ndihmës, Akademik, Administrativ, Bordit dhe funksioneve të tjera” shpjegohet organizimi i këtyre strukturave si edhe lista e personave në secilën strukturë. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete ndihmëse (siç është rasti i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, stafi i së cilës jep njëkohësisht edhe mësim pranë Masterit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës. Stafi ndihmës ka një orar të afishuar pritjeje për studentët dhe publikun.</p>
---	---

Standardi III.8 – Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa e stafit akademik është mjaft pozitive si përsa i takon lëndëve ashtu edhe përsa i takon orëve mësimore, duke marrë konsideruar në këtë përlllogaritje edhe ngarkesën akademike që ata mund të kenë në programe të tjera të IAL. Kështu pjesa më e madhe e PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë më të ulët se 200 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme prej 195 orësh çka i</p>
--	--

	<p>krijon mundësinë që të mbulojë edhe aspektet administrative dhe kërkimore të pozicionit. I vetmi rast për tu rishikuar është ai i Z. Kriton Kuci i cili ka një ngarkesë prej 270 orësh (përveç edhe faktit që është anëtar i zyrës së marrëdhënieve me jashtë), e cila mund të mos favorizojë punën e tij për përfundimin e doktoraturës, një hap ky i nevojshëm për rritjen e nivelit akademik të PAE siç edhe u tha më lart. Pas konsultimit të programeve mësimore të paraqitura, vihet re një ngarkesë e ekuilibruar si në numrin e orëve ashtu edhe të lëndëve, për të gjithë periudhën e akreditimit (2012-2018). Megjithëse në RVB mungon informacioni mbi këtë pikë, nga shqyrtimi i dokumentave mbi ngarkesën mësimore, mbi planet mësimore dhe shpërndarjen e pedagogëve sipas lëndëve mendojmë se ngarkesa e personelit vlerësohet me orë mësimore.</p>
--	---

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program duke përfshirë si CV e pedagogëve (e cila disponohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore) ashtu edhe publikimet shkencore.
 Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB (faqe 28), në pjesëmarrjen e personelit akademik dhe ndihmës në programet akademike të pasqyruara ndër vite dhe ngarkesën respektive, mund të themi se UMSH disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor-shkencor.
 Një pasqyrë e plotë mbi publikimin e kriterëve dhe procedurave të rekrutimit si edhe mbi transparencën e të gjithë procesit të rekrutimit ofrohet në dokumentin “Përmbledhje e procedurës së rekrutimit”, çka bën që institucioni ta përmbushë këtë aspekt.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ngarkesa si e lëndëve ashtu edhe e orëve mësimore të pedagogëve jo vetëm në këtë program por edhe në programet e tjera të institucionit është përgjithësisht në përputhje me normat ligjore të përcaktuara.
2. Në shumicën e rasteve ka një përputhshmëri midis profilit akademik të pedagogëve dhe lëndëve që mbulojnë në program, por ka edhe disa raste ku duhet të tregohet më

shumë vëmendje.

3. Raporti PAE/PAK dhe i ngarkesës mësimore është si vijon:

2017-2018: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 67% dhe PAK 33%.
PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 73% dhe PAK 23%.

2016-2017: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 66.7 % dhe PAK 33.3%.
PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 70% dhe PAK 30%.

2015-2016: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 63.6 % dhe PAK 36.4 %.

2014-2015: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 66.7 % dhe PAK 33.3%.

2013-2014: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 69.2 % dhe PAK 30.8%.

2012-2013: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 61.5% dhe PAK 38.5%.

4. Ka një hendek moshor ndërmjet gradave akademike sidomos përsa i takon PAE. Vihet re gjithashtu, një nevojë e ngutshme për të rritur nivelin akademik të PAE, megjithëse është në përmbushje të detyrimeve ligjore.

5. Strukturat ndihmëse dhe administrative japin një ndihmë pozitive në procesin e mësimdhënies dhe atij të kërkimit shkencor.

6. Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit bëhen në përputhje me normat ligjore.

Standardet plotësohen kryesisht.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga pikëpamja e infrastrukturës, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është i pajisur me kapacitetet e nevojshme mjedisore jo vetëm për shërbimet që lidhen me procesin e mirëfilltë akademik, por edhe me ato dytësore, të shërbimit studentor. UMSH ka një numër të mjaftueshëm mjedisesh leksionesh, prej 6 amfiteatros (me 100-120 vende të ulura) dhe 15 sallash seminaresh. ~~Infrastruktura është bashkëkohore dhe me lehtësi aksesit edhe për personat me aftësi të kufizuar.~~ Teknologjia e informacionit që zbatohet në universitet përbëhet nga laboratorë të teknologjisë bashkëkohore, dhe laboratorët e gjuhëve të huaja. Gjithashtu referuar RVB-së dhe vizitës në institucion (*gjatë vizitës së vëzhgimit të infrastrukturës, me koordinatoren e institucionit. Këqyrja fizike përputhet me të dhënat e raportuara në RVB (fq. 28-32)*), ekzistojnë 8 zyra për departamentet/qendrat kërkimore dhe dy zyra për personelin akademik. Sa i takon bibliotekës, ekzistojnë hapësira të mjaftueshme dhe komode për zhvillimin e punës shkencore dhe kërkimore të studentëve. Biblioteka ofron edhe shërbimin online me një numër të konsiderueshëm titujsh, ndërsa UMSH është regjistruar në Questia, një ndër databazat akademike më të mëdha në nivel global. Shërbimet e tjera të studentëve përfshijnë personelin administrativ dhe teknik, i pajisur me mjedise të përshtatshme pune, në

gjendje të përmbushë detyrimet e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Struktura të tjera mbështetëse janë Zyra e Arkivës dhe Protokollit, e cila përmbush detyrimet lidhur me arkivimin e dokumentacionit shkresor dhe online të UMSH-së. Pjesë e infrastrukturës mbështetëse të procesit akademik është Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Pranimit, Zyra e Financës, Burimet Njerëzore dhe Zyra e Këshillimit Studentor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare


Për një numër të plotë të këtyre mjediseve, shih në *Aneks Tabelën 6.1*. Nga këqyrja në institucion, rezulton një përputhje e plotë midis mjediseve të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Për një numër të plotë të këtyre mjediseve, shih në *Aneks Tabelën 6.2*. Nga këqyrja në institucion, rezulton një përputhje e plotë midis mjediseve të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Nga vizita në institucion rezulton një përputhshmëri e plotë e gjendjes së konstatuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në RVB. Kështu nga këqyrja fizike e sallave për leksione, atyre për seminare, mjediseve të bibliotekës, zyrës së informacionit, mjediseve të shërbimit, nyje hidrosanitare, etj, ka sasi dhe sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e procesit mësimor dhe për komoditetin e personelit akademik e atij administrativ/mbështetës.



- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Listë e titujve në bibliotekë për programin e studimit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka një vendndodhje të përhershme dhe të qëndrueshme brenda së cilës zhvillohen veprimtaritë mësimore dhe kërkimi shkencor. Në përputhje me kriteret e specifikuar dhe bazuar në RVB (fq. 28-32), këto mjedise konsiderohen funksionale dhe të vazhdueshme në një afat kohor të gjatë, mbi 6 vjet (godina e universitetit është marrë me qera për një afat jo më pak se 10 vjet).</p> <p>Programi studimor i Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare ofrohet brenda mjediseve të godinës së institucionit, ndërsa garanton menaxhimin efikas të mjediseve të tij.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshatje me oraret e programeve të studimeve dhe</p>	<p>Në përgjithësi infrastruktura e bibliotekës është e bollshme dhe procesi kërkimor shkencor i studentëve në nivelin e Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare lehtësohet nga aksesin në burime elektronike dhe bibliotekat online, si Questia apo The Economist. Databaza elektronike ndërkohë ishte e gjerë dhe me një numër shumë të madh titujsh, të cilët mund të aksesohen nga studentët edhe online, nga shtëpitë e tyre.</p> <p>Institucioni ka marrë një sërë masash për të nxitur punën e studentëve të nivelit Master Shkencor, edhe në kuadrin e kërkimeve të tyre shkencore, për të shfrytëzuar më shumë aksesin online, në databazat e sipërpërmendura.</p> <p>Në përgjithësi biblioteka përmbush nevojën e realizimit të projekteve kërkimore-shkencore të studentëve dhe stafit akademik, si dhe për përgatitjen e punimeve finale (punimeve të diplomave) të studentëve, të cilat kanë nevojë për literaturë përtej asaj të ofruar gjatë kurseve.</p>

<p>nevojat e studentëve.</p>	<p>Literatura e ofruar nga biblioteka është e ndarë sipas programeve të studimit dhe në përputhje me fushat përkatëse.</p> <p>Shërbimi i bibliotekës është i shtrirë në fasha orari të zgjatura dhe të përshtatshme për studentët dhe kërkuesit e tjerë shkencorë pranë institucionit.</p> <p>Ndërkohë që në RVB konstatohet se “Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, etj.”, ky përfshin pasurimin e saj të menjëhershëm pas kërkesave të lektorëve për literaturën e lëndëve të tyre.</p>
------------------------------	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe analiza e RVB-së, rezulton se institucioni ka infrastrukturë shumë të përshtatshme mësimore, në përpjestim me numrin e studentëve që ai ka për programin mësimor në shqyrtim. Sallat dhe klasat mësimore janë dy lloje, për leksione dhe për seminare, dhe të pajisura me mjetet e duhura audio-vizuale të teknologjisë së informacionit, në funksion të programit të studimeve në shqyrtim.</p> <p>Për shkak të natyrës së programit, që lidhet me shkencat sociale e konkretisht me fushën studimore të politikës ndërkombëtare, laboratorët e nevojshëm gjykohet se janë ato informatikë, me akses në burime online informacioni dhe dijeje si dhe të përshtatshëm për projekte të ndryshme studentore (e gjithë paketa Microsoft Office). Këta laboratorë ishin plotësisht të përshtatshëm për përmbushjen e objektivave të programit në studim.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Nga shqyrtimi i mjediseve mësimore bazuar në RVB dhe këqyrje në institucion, ato janë plotësisht të përshtatshme nga pikëpamja infrastrukturore dhe ajo informatike (laboratorë kompjuterikë) për zhvillimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e objektivave të programit.
2. Rekomandohet përditësimi i teksteve me tekste më bashkëkohore dhe të shtëpive botuese më të rëndësishme për fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare/diplomacisë.

Standardet plotësohen plotësisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Nga pikëpamja financiare, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gëzon një status të veçantë juridik, unik në llojin e tij, pasi është projekt i OJF-së me emër "Qendra Mesdheu", regjistruar me Vendim Nr. 441, 06/07/2007, me objekt shërbimet në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. UMSH monitorohet nga Bordi i Administrimit si struktura më e lartë që siguron menaxhimin financiar dhe administrativ. Nga shqyrtimi i rregullores (*Rregullorja organizative e UMSH-së, neni 31*), RVB-së dhe procedurave të menaxhimit financiar gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kontrolli dhe auditimi i brendshëm kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm që emërohet nga autoriteti më i lartë menaxhues i institucionit (Bordi i Administrimit).

Garantimi i implementimit të strategjisë financiare të institucionit bëhet i mundur nga Zyra e Financës, që ndjek zbatimin e procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Nenin 31 të Rregullores së institucionit.


Situata financiare e institucionit i është nënshtruar auditeve edhe nga ekspertë të huaj, si shoqëria Crowe Horwath Al shpk. Ajo i plotëson kriteret dhe standardet për qëndrueshmërinë financiare afatshkurtër dhe afatmesme, në përputhje me kriteret ligjore të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) (*Tabela 7 në Aneksë*):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion (*takimi me drejtuesin e Strukturës për Punën Kërkimore dhe Shkencore*) rezultoi se të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontrata kanë qenë 0 (zero) gjatë periudhës 2012-2016 (periudha e përfshirë në raportim në tabelën 8 RVB, fq. 34), ndërsa të vetmet të ardhura janë mundësuar gjatë vitit 2017, në vlerën 1.599.000 lekë. Kjo është një vlerë shumë e vogël (nën 1%) në raport me totalin e të ardhurave të institucionit.



Zëri kryesor i të ardhurave është nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, të cilat kanë shënuar një rritje konstante nga viti në vit (që prej vitit 2012 kur janë vënë në dispozicion të dhënat – RVB, fq. 34, Tabela 8), deri në 2017, kur këto të ardhura ishin 293.645.000 lekë. Ndërkohë që një përqindje shumë e vogël të ardhurash (nën 1%) lidhet me aktivitetet tregtare.

Vihet re se të ardhurat nga konsulencat, shërbimet dhe shërbimet trajnuese janë 0 (zero), çka mund të përbëjë një mundësi për të gjeneruar të ardhura si fryt i punës kërkimore shkencore që mund të realizohet në këtë program për llogari të të tretëve. Ky është një potencial i pashfrytëzuar që në të ardhmen mund të kthehet në gjenerues të ardhurash për institucionin.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)


Bazuar në raportimin financiar të vitit akademik kostoja financiare për student, për vitin akademik 2014-2015 ishte 102.000 lekë (mbi një total të financimit prej 215.443.000 lekë); për vitin akademik 2015-2016 kostoja për student ishte 106.000 lekë (mbi një total të financimit 215.443.000 lekë); për vitin akademik 2016-2017 kostoja për student ishte 106.000 lekë (për një total të financimit prej 254.137.000 lekë); kurse për vitin 2017-2018 kostoja për student është 137.000 lekë (për një total financimi prej 288.522.000 lekë) (Tabela 8 në Aneksë). Gjatë periudhës së sipërpërmendur vihet re se ndërsa ka një rritje konstante të financimit në nivel institucioni, kostoja për student ka qenë relativisht konstante.

Bazuar në të dhënat e RVB-së (fq. 33-36) të vëna në dispozicion nga Institucioni, rezultojnë se të ardhurat financiare janë të kënaqshme dhe se ato janë rritur në mënyrë konstante gjatë viteve të fundit dhe konkretisht gjatë periudhës 2012-2017, nga 93.332.000 lekë (2012) në 298.606.000 lekë (2017). Kjo tregon se institucioni ka një qëndrueshmëri financiare ndër vite, e cila e bën të përballojë me sukses objektivat akademike. Gjithashtu këto burime bazohen në masën mbi 99% tek të ardhurat nga tarifat e shkollimit, ndërsa nuk ka të ardhura nga grantet për kërkime, nga fonde jopublike ose publike, apo nga burime të tjera. Nga vizita në institucion rezultoi se këto të dhëna përputhen me evidencat dhe treguesit në terren. Kontrolli financiar dhe auditimi brendshëm e i jashtëm financiar menaxhohen në përputhje me standardet dhe kriteret ligjore kombëtare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	UMSH përmbush plotësisht kriteret e auditit të situatës financiare për përdorimin e buxhetit të ciklit të dytë, konkretisht të programit Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, në funksion të rritjes së cilësisë së studimit dhe forcimit të cilësisë e kapaciteteve të stafit akademik. Auditimi është i përvitshëm dhe adreson plotësimin e
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të	

<p>dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>kërkesave ligjore dhe miratimin e pasqyrave financiare. Gjithashtu auditit shprehet çdo vit dhe mbi situatën financiare të Qendrës Mesdheu. Në pasqyrat e vendosura në dispozicion rezultojnë se të ardhurat nga grantet, konsulenca dhe shërbimet për të tretë zënë një vend shumë të vogël të burimeve financiare të programit, ndërsa mbi 99% e të ardhurave bazohet tek tarifat e shkollimit.</p> <p>Bordi i Administrimit, si autoriteti më i lartë i menaxhimit financiar, kërkon dhe merr në shqyrtim raportet e realizimit të buxheteve në funksion të rritjes së cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimit të stafit akademik.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura në RVB (fq. 33-36) dhe nga konstatimet e vizitës në Institucion (<i>takimi me zyrën e Burimeve Njerëzore</i>), këto kritere konsiderohen të përmbushura. Në raportet financiare të shqyrtuara rezultojnë se Institucioni ka krijuar të ardhura të qëndrueshme gjatë periudhës kohore 2012-2018, ka kryer investime në infrastrukturën e mësimdhënies, në hapësirat dhe mjediset ku zhvillohet puna akademike e shkencore, por edhe e ka pajisur atë me sisteme bashkëkohore elektronike. Të gjitha këto janë pasqyruar në raportet financiare. Qëndrueshmëria financiare bazohet në rritjen konstante të të ardhurave.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni përmbush plotësisht kriteret e auditit të situatës financiare për përdorimin e buxhetit të ciklit të dytë në funksion të rritjes së cilësisë së studimit dhe forcimit të cilësisë e kapaciteteve të stafit akademik. 2. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare. <p><u>Standardet plotësohen plotësisht.</u></p>	



6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni ka ngritur një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë që ka si objektiv garantimin e përputhshmërisë së veprimtarisë mësimore, akademike, shkencore dhe administrative me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe aktet e tjera institucionale. Për këtë UMSH rezultoi se ka ngritur një strukturë të përhershme që ka integruar cilësinë dhe kurrikulat, të quajtur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Njësia kryen kontrole dhe vlerësime të rregullta mbi të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore. Funksionimi i saj rregullohet nga një sërë dokumentesh dhe urdhërash, si Manuali i Sigurimit të Brendshëm, etj.


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

NJSBCZHK kryen çdo vit anketime me studentët. Këto anketime kryhen në përfundim të çdo semestri akademik, nëpërmjet pyetësorëve që u shpërndahen studentëve përpara se ata të zhvillojnë provimet e lëndëve përkatëse. Pjesëmarrja e studentëve në këto anketime është 60% e numrit të tyre në çdo vit akademik. Në vijim të procesit të anketimeve, Njësia përpunon rezultatet vetëm nga 25% e anketimeve të zgjedhura në mënyrë rastësore. Rezultatet e anketimit raportohen pranë fakulteteve dhe në nivel rektorati, shoqëruar me arsyetimin e tyre dhe me sugjerimet për ndryshime të mundshme. Nga analiza e RVB-së (fq. 37-43) dhe takimi në institucion me NJSBCZH (takimi me drejtuesen e njësisë), rezultoi se ka pasur disa raste kur institucionit i janë dhënë rekomandime konkrete për punën e pedagogëve dhe tematika lidhur me mësimdhënien, të cilat janë adresuar në vijim prej tyre, për të përmirësuar procesin. Në disa raste ka pasur edhe marrje masash ndaj pedagogëve (sipas takimit me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, si dhe me Zyrën e Burimeve Njerëzore). Kjo u konstatua edhe nga takimi me studentët, të cilët u shprehën në përgjithësi se mendimet e tyre janë marrë në konsideratë.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Funksionimi i njësisë rregullohet nëpërmjet një agjende në nivelin e vitit akademik, ku renditen prioritetet vjetore, forma e kontrollit, sektorët dhe proceset të cilat do të bëhen objekt kontrolli. Njësia ka gjithashtu detyrim kryesor llogaridhënien për gjetjet dhe vlerësimet e saj në Rektorat, në fakultetet dhe me stafin e UMSH-së. Bazuar në raportin e RVB-së dhe në takimet e zhvilluara në institucion (ka një përputhshmëri midis RVB-së (fq. 36-43) dhe takimit me stafin



akademik të departamentit), procesi i raportimit të gjetjeve tek pjesëtarët e stafit akademik dhe administrativ është sekretiv dhe në respekt të konfidencialitetit. Objektivi është marrja e masave për adresimin e problematikave të ngritura, në funksion të rritjes së performancës së personelit akademik dhe administrativ, si dhe përmirësimit të cilësisë së institucionit në tërësi. Njësia i kushton vëmendje trajnimit periodik të stafit akademik dhe atij administrativ, që kryhet kryesisht në fillim të vitit akademik. Gjithashtu trajnimet zhvillohen edhe në grupe më të vogla, me stafin e pedagogëve të jashtëm, për të shpjeguar proceset administrative, detyrimet, rregulloren e institucionit, organizimin e proceseve të mësimdhënies, etj. (takimi me drejtuesen e Njesisë).

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBCZHK kryen monitorime periodike jo vetëm të procesit të mësimdhënies në nivelin e stafit akademik individual, por edhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore në nivel departamenti. Gjetjet e këtyre vlerësimeve/monitorimeve diskutohen në mënyrë intensive midis anëtarëve të njësisë dhe përfaqësuesve të departamenteve, në funksion të përmirësimit të cilësisë së departamentit. Nga vizita në institucion (takimi me drejtuesen e Njesisë) dhe RVB (fq. 36-43.), rezulton se ky proces shoqërohet me një plan masash konkrete, në formën e angazhimeve dhe të detyrave që merr përsipër çdo njësi departamentale gjatë periudhës në vijim.


Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Puna e Njesisë bazohet kryesisht në anketimin e studentëve lidhur me lëndët dhe institucionin në përgjithësi. Në raste të konstatimeve të problematikave të theksuara, ato shoqërohen me marrje masash ndaj pedagogëve. Raste të tilla janë përmendur edhe gjatë vizitës në institucion nga stafi akademik por edhe studentët e Masterit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e lidhen kryesisht me literaturën e rekomanduar, mënyrën e zhvillimit të mësimi, cilësinë, provimet, etj. Vlerësimi periodik i personelit akademik bëhet në mënyrë të institucionalizuar dhe realizohet në mënyrë vertikale dhe horizontale, me përfshirjen e Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit, si dhe vlerësimi i performancës kërkimore-shkencore. Ky vlerësim kryhet dy herë në vit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në themel të politikave të përmirësimit të cilësisë të UMSH-së qëndron angazhimi i marrë si produkt i raportit vjetor të vetëvlerësimit, të hartuar dhe miratuar nga NJSBCZHK. Çdo njësi merr detyrat përkatëse dhe harton një plan-veprimi për të adresuar komentet/sugjerimet/udhëzimet e raportit. Rezulton se plan-veprime të tilla në formë të shkruar dhe të miratuar nuk ekzistojnë ose janë ende në proces hartimi.

Dosja e vetëvlerësimit përmban informacion të qartë dhe të plotë mbi procesin e ngritjes dhe funksionimit të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. Ajo spjegon në mënyrë të detajuar institucionalizimin e kësaj strukture dhe rolin e saj në garantimin e cilësisë akademike dhe infrastrukture. Në dosje pasqyrohet në mënyrë të plotë roli dhe përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të pedagogëve dhe institucionit, si dhe



nga bashkëbisedimi me studentët u ofruan spjegime/raste të marrjes parasysht të vërejtjeve të tyre nga pedagogët dhe/ose institucioni. Përveç kësaj, nga këqyrja në institucion e praktikave të funksionimit të NJSBCZHK-së rezultoi se njësisia ka një rol të rëndësishëm në procesin e garantimit të cilësisë së institucionit.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Model vlerësimi i stafit akademik
 - Vlerësim i performancës së stafit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në 	<p>Kriteret që zbaton institucioni për të vlerësuar cilësinë e brendshme burojnë nga Statuti i tij, nga Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (miratuar nga Senati Akademik), nga Ligji për Arsimin e Lartë (Nr. 80/2015) dhe nga dokumentacioni i ASCAL-it.</p> <p>Institucioni përdor një tërësi mekanizmesh për të vlerësuar dhe siguruar cilësinë e brendshme, përfshirë kontrollet brenda-institucionale, anketimet me studentët, grupet e monitorimit në nivel departamenti dhe përditësimin e publikimin e rezultateve të procesit. NJSBCZHK ka pika kontakti në çdo departament, të cilët janë pedagogë që luajnë rol koordinues dhe facilitues të procesit të vlerësimit të brendshëm</p> <p>Sugjerohet në këtë pikë që mekanizmi i kontrollit të cilësisë të shtrihet dhe në nivel silabuesh, jo përmbajtësor por formal, për të garantuar respektimin e standardeve të vendosura nga vetë institucioni.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore të vetë pedagogëve, si dhe nëpërmjet anketimeve me studentët, duke i reflektuar në vlerësimin e performancës së pedagogut në fund të vitit akademik. Nga vizita në institucion rezultoi se ky ishte vetëm një prej aspekteve të vlerësimit të punës së pedagogëve.</p>

<p>provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Gjithashtu të dhëna të tjera që përpunohen dhe kryqëzohen nga NJSBCZHK janë intervistat gjysëm të strukturuar me studentët, kalueshmëria për lëndë e pedagogëve, etj.</p> <p>Metodat e vlerësimit janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anketimet e studentëve për programet, pedagogjinë, etj. - Intervista gjysëm të strukturuar. - Një metodë më e drejtpërdrejtë është dëgjesa në auditor nga Dekani dhe/ose Përgjegjësi i Departamentit. - Vlerësimi me pikë dhe analiza e mënyrës së vlerësimit të Detyrave të Kursit.
--	---

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raportet marrin edhe formën e broshurave të programeve dhe përdoren për të identifikuar pikat e forta të institucionit bazuar në vlerësimin e brendshëm. (<i>Dokumenti "Vlerësimi i Performancës së Stafit" dhe "Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i>.)</p> <p>Institucioni i përdor këto raporte periodike si bazë kur diskuton në nivel departamenti për përmirësimin e cilësisë dhe për hartimin e plan-veprimeve në përmbushje të kërkesave të raporteve periodike të Njësisë.</p>
---	--

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga RVB dhe takimet në institucion me përfaqësuesit e zyrës së NJSBCZHK-së, rezulton se përgatiten raporte periodike të cilësisë, të cilat u vihen në dispozicion të gjithë aktorëve dhe janë transparente.</p>
--	--

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar e ri-akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të</p>
--	--

<p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>studimeve, pasi programet për të cilat po kryhet procesi i akreditimit periodik janë akredituar në vitin 2012.</p> <p>Institucioni përdor mjetet e duhura për sigurimin e cilësisë sepse ai përfshin në proces një numër aktorësh të rëndësishëm, si studentët, NJSBCZHK-në, departamentet, dekanatin, etj. Përfshirja në proces është thelbësore, ndonëse sugjerohet përmirësimi i standardizimit të silabuseve dhe kontrollit formal të tyre si dhe mekanizma shtesë të vjeljes së gjykimit të studentëve nëpërmjet fokus-grupeve, apo kontrolli (rastësor) mbi vlerësimin e tezave. Raportimet që nxjerr institucioni janë të vlefshme për kontrollin e nivelit të cilësisë së tij të brendshme dhe periodicitetin i tyre i vendos në kushtet e ndërtimit dhe monitorimit të plan-veprimeve për adresimin e problematikave të mundshme të shfaqura.</p> <p>Institucioni gjithashtu e ka pjesë të strategjisë së tij të zhvillimit fuqizimin e mëtejshëm të NJSBCZHK-së.</p>
<p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni gjithashtu e ka pjesë të strategjisë së tij të zhvillimit fuqizimin e mëtejshëm të NJSBCZHK-së.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni përdor mjetet e duhura për sigurimin e cilësisë sepse ai përfshin në proces një numër aktorësh të rëndësishëm, si studentët, KSBCZHK-në, departamentet, dekanatin. 2. Puna e KSBCZHK-së mund të shtrihet në të ardhmen edhe në procesin e kontrollit të silabuseve të lëndëve, nga pikëpamja e përmbushjes së kriterëve të tyre formale. Kjo do të garantonte një formë më të plotë të kontrollit të dyfishtë të tyre, nga Departamenti dhe Njësia. 3. Rekomandohet zhvillimi edhe i fokus-grupeve me studentët, për të forcuar kuptueshmërinë e cilësisë së institucionit, përtej anketimeve me studentët dhe intervistave me ta. 4. Sugjerohet gjithashtu këqyrja rastësore e mënyrës së korrigjimit të tezave nga pedagogët, kryesisht për të identifikuar raste të ndryshimeve të pajustificuara të notave, në funksion të forcimit të cilësisë. 5. Duhet standardizuar formatet, sidomos ato që përfshijnë elementë cilësorë. 6. Një sugjerim tjetër lidhet me standardizimin e performancës së kërkimit shkencor të stafit akademik. <p><u>Standardet plotësohen plotësisht.</u></p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi akademik ka si qëllim thellimin dhe zgjerimin e njohurive teorike dhe praktike në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare duke synuar që të pajisë studentin me aftësitë profesionale dhe njohuritë e nevojshme për të qenë sa më konkurrues në tregun e punës. Për të bërë të mundur asimilimin sa më të mirë të këtyre njohurive IAL është përpjekur të përzgjedhë stafin akademik dhe të bëjë organizimin e programit, shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe informimin e studentëve mbi programet e ofruara në mënyrë sa më të plotë. Duke u bazuar edhe në eksperiencat ndërkombëtare, programi përpiqet që të ofrojë një cilësi mësimdhënie që është në standardet dhe nivelet e kërkuara nga arsimi i lartë në Shqipëri. Programi organizohet në bazë të dy viteve akademike dhe në bazë të sistemit të Bolonjës ofron 120 ECTS (60 ECTS për secilin vit akademik).

Qëllimi dhe objektivat e programit megjithatë nuk janë ofruar në mënyrë shumë të qartë dhe përdoren në disa raste si koncepte në shkëmbim të njëri-tjetrit, siç janë për shembull qëllimet dhe objektivat e programit. Shpjegimi i objektivave dhe qëllimeve është bërë në mënyrë të përgjithshme çka dëmton në njëfarë mase lidhjen ndërmjet objektivave të programit dhe planit mësimor apo organizimit të lëndëve.


Organizimi i programit është bërë në dy vite akademike ose 60 javë, ose 30 javë për çdo vit akademik, (në RVB fq. 43, javët mësimore në auditor në 1 vit akademik janë dhënë gabim) ndërsa një semestër është 15 javë.

Vetë programi është i organizuar në bazë të krediteve ECTS sipas procesit të Bolonjës nga të cilat 85 ECTS përfitohen gjatë lëndëve të përfundimit të lëndëve të parashikuara në planin mësimor dhe 35 ECTS për praktikën dhe diplomën. Edhe ndarja e orëve dhe e lëndëve është organizuar në bazë të ECTS duke harmonizuar si punën e studentëve në auditor (leksione frontale, punë në grupe apo prezantime) ashtu edhe punën e pavarur në përgjithësi.

Megjithatë programi duhet të reflektojë më shumë inter-disiplinaritetin e tij pasi mungon një qasje sado e vogël ndaj shkencave politike. Një njohje e pa-mjaftueshme e kësaj discipline (pa mohuar rolin e të drejtës dhe ekonomisë ndërkombëtare) ofron një shpjegim të mangët të qëllimeve, interesave dhe objektivave të aktorëve kryesore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare (qofshin këto shtete apo organizata ndërkombëtare apo ndër-shtetërore).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi



Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2011-2012 dhe më pas është akredituar nga Ministria e Arsimit për një periudhë 6-vjeçare. Megjithëse ka një vizion të përgjithshëm lidhur me qëllimet dhe objektivat e programit, përsëri do të ishte më e vlefshme që informacioni në këtë pikë ti përgjigjej në mënyrë të saktë pyetjes. Një ndarje e saktë midis qëllimit dhe objektivave. I pari prezanton arritjet finale nga ana akademike të studentëve ndërsa i dyti shpjegon së çfarë rezultatesh dhe aktivitetesh duhet të synohen dhe realizohen për të realizuar këtë qëllim. Pra nëse qëllimi është përgatitja e diplomatëve të ardhshëm objektivat lidhen me ofrimin e lëndëve dhe metodave të mësimdhënies që përputhen me këtë qëllim, një program i mbështetur në një metodologji inter-disiplinare (E drejta ndërkombëtare, shkenca politike, ekonomi ndërkombëtare, institucione ndërkombëtare, histori bashkëkohore, etj). kombinimi i aspektit teorik me atë praktik dhe në çfarë rezultatesh duhet të konsistojë ky i fundit. Të gjitha këto informacione mungojnë dhe dokumentacioni i ofruar është shumë i përgjithshëm. Nuk u ofrua më shumë informacion edhe gjatë vizitës në institucion.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS ka 25 ore mesimore
- 1 orë mesimore ka 60 minuta


Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor brenda një cikli të programit është ndarë në dy vite akademike me nga 60 ECTS secili prej tyre, për një total prej 120 ECTS. Ngarkesa e çdo lënde është shprehur në numrin e orëve dhe vlerën respektive në ECTS. Organizimi i moduleve të ofruara është bërë në bazë të raportit orë mësimi ECTS. Orët e mësimi janë të ndara në auditor, seminare dhe punë e pavarur e studentëve (ndërkohë që këtu llogariten edhe orët e praktikës profesionale dhe të shkrimit të tezës së diplomës). Në periudhën e marrë në shqyrtim programi ka pësuar disa ndryshime (siç është futja e lëndës “International Relations” në anglisht), të cilat nuk kanë cënuar karakteristikat kryesore të tij. Në përgjithësi, në të gjitha vitet e marra në shqyrtim, dhe në të gjitha modulet, ka një shpërndarje orësh e cila favorizon punën e pavarur të studentit në krahasim me orët në auditor. Po kështu, raporti i orëve në auditor me seminarët qëndron në shkallën 2:1 në modulet dhe vitet e paraqitura. Mënyra kryesore e vlerësimit të studentëve është provimi, ndonëse në disa prej moduleve parashihen edhe mënyra të tjera integruese siç janë projektet kërkimore apo puna në grup si pjesë e vlerësimit përfundimtar. Plani mësimor i detajuar jepet në Tabelën 10 në Aneksë.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminarët 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminare Detyra 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara



Është realizuar vetëm zëvendësimi i një lënde, e cila ishte: “Identiteti dhe Imazhi si Faktor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare” ndërsa tani është: “International Relations”. Duke qenë se kjo lëndë ka një vlerë prej 7 ECTS atëherë ndryshimi nga akreditimi i fundit është vetëm 5.8% dhe respekton kriterin e parashtruar për një ndryshim më të vogël se 20%.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Duke u mbështetur në planet mësimore të paraqitura mund të themi se pjesa më e madhe e lëndëve janë të mbuluara nga PAE.

Për vitin 2017-2018: 7 lëndë janë ofruar nga PAE, 2 lëndë janë ofruar nga PAK dhe 3 lëndë janë ofruar bashkarisht.

Për vitin 2016-2017: 9 lëndë janë ofruar nga PAE, 3 lëndë janë ofruar nga PAK.

Për vitin 2015-2016: 8 lëndë janë ofruar nga PAE, 4 lëndë janë ofruar nga PAK.

Për vitin 2014-2015: 8 lëndë janë ofruar nga PAE, 4 lëndë janë ofruar nga PAK

Për vitin 2013-2014: 8 lëndë janë ofruar nga PAE, 3 lëndë janë ofruar nga PAK dhe 1 lëndë janë ofruar bashkarisht.

Për vitin 2012-2013: 8 lëndë janë ofruar nga PAE, 3 lëndë janë ofruar nga PAK dhe lëndë janë ofruar bashkarisht.


Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Aneksi dhe informacioni i paraqitur nga UMSH, përmban në përgjithësi të gjitha informacionet e kërkuara në pikat e mësipërme, ndonëse nuk i respekton emërtimet dhe informacioni në disa raste është i shpërndarë ndërmjet seksioneve të objektivave dhe përshkrimit të lëndës. Mungojnë në disa raste përgjigja ndaj pikës: Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, sikundër mungon pothuajse në të gjitha rastet përgjigja ndaj pikës: Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga informacioni i vënë në dispozicion ofrohet një përshkrim i modelit të syllabusit të paraqitur edhe në aneksin përkatës dhe jo një analizë e cila të dëshmojë arsyet e finalizimit të këtij syllabusi duke patur parasysh objektivat e programit dhe qëllimin e tij.



Rekomandime: Në rradhë të parë duhet të cilësohet qartë që ky është një program inter-disiplinar pavarësisht faktit se është ngritur pranë një fakulteti të caktuar. Në të duhet të harmonizohen së paku tre disiplina bazë: a) Shkencat juridike (ndërmjet të drejtës ndërkombëtare); b) Shkencat ekonomike (ekonomia ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare të zhvillimit si Banka Botërore apo ato që sigurojnë rigorozitetin financiar si FMN); c) Shkencat politike dhe politika ndërkombëtare. Në rast se për dy të parat ka një mbulim relativisht të kënaqshëm, tema e tretë është prekur përciptas në program. Është e vështirë që të kuptohet deri në fund roli i një shteti apo i të gjithë aktorëve ndërkombëtarë kur nuk studiohen rrymat kryesore që analizojnë pikërisht arsyet e sjelljes, interesat dhe objektivat e aktorëve më të spikatur që veprojnë në arenën ndërkombëtare.

Ka një numër të kufizuar lëndësh formuese të tipit A, duke patur parasysh faktin se studentët të cilët ofrohen në këtë lloj masteri interdisiplinar vijnë nga disiplina të ndryshme dhe (juridike, shkenca politike, apo shkenca ekonomike e sociale) kanë nevojë për një prezantim më të plotë të njohurive bazë në këtë fushë. Në të kundërt, programi mund të frekuentohet vetëm nga studentë që kanë një bachelor në marrëdhënie ndërkombëtare dhe kanë më shumë nevojë për lëndë specializuese sesa formuese. Megjithatë kjo strategji do të binte ndesh me objektivat e institucionit për rritjen e numrit të studentëve.

Çfarë bie në sy është një lloj specifikimi i tematikave gjatë vitit të parë të programit. Është e vështirë të krijohet një bazë solide në vitin e parë kur nuk studiohet politika ndërkombëtare dhe ajo e BE. Për të parën nuk ka një modul të dedikuar, ndërsa përsa i takon politikave të BE-së ofrohet një modul që fokusohet në institucionet evropiane dhe administratën e tyre, por moduli është megjithëse shumë i shtrirë në objektivat e tij (ç'ka duket dhe nga nën-temat e problematikave të shumta që ofron) nuk ofron asgjë mbi politikave publike të bashkimit evropian (mjafat të rëndësishme kur flitet për integrimin e vendit në BE). Do të ishte me vend që strukturat dhe procedurat institucionale të bashkimit evropian të trajtoheshin pjesërisht ose tërësisht në nivelin bachelor (është vështirë të kuptohet një student i bachelor në marrëdhënie ndërkombëtare që nuk njih institucionet e BE dhe procedurat normative të aktivitetit të tyre). Një frymëmarrje më e gjerë e këtyre tematikave mund të zëvendësonte tema siç janë marrëdhëniet ndërkombëtare pas luftës së ftohtë, të cilat nuk përbëjnë një gur themeltar në njohjen e koncepteve bazë dhe mund të vendosen fare mirë gjatë vitit të dytë të programit.

Po kështu do të ishte me vlerë një vështrim i institucioneve ndërkombëtare në përgjithësi gjatë vitit të parë dhe jo vetëm i OKB-së. Pavarësisht rolit të saj qëndror (por edhe tepër të diskutuar nga shumë studiues) ky nuk është i vetmi institucion ndërkombëtar i pas-luftës së dytë botërore. Përveç institucioneve financiare dhe të zhvillimit si Banka Botërore dhe FMN kemi edhe organizata kontinentale siç janë Mercosur dhe ASEAN me një rol gjithnjë në rritje në arenën ndërkombëtare, apo edhe organizata rajonale apo me interesa ekonomike si WTO, EFTA dhe OPEC.

Më tej, lënda International Relations ofron njohuritë themeltare përsa i takon kursit dhe është më e udhës që të vendoset gjatë vitit të parë të studimeve duke zhvendosur për shembull lëndën mbi krizat ndërkombëtare dhe zgjidhjen paqësore të tyre në vitin e dytë. Është e vështirë për studentin që të kuptojë mekanizmat e zgjidhjes së krizave sa kohë nuk njih organizatat ndërkombëtare, mënyrën se si ato veprojnë dhe kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet ndërkombëtare (i cili me të drejtë është vendosur në vitin e parë).

Disa nga pikat që duhen mbajtur parasysh nga institucioni:

- Informacionet në RVB janë përshkruese dhe jo analizuese;
- Të theksohet më qartë natyra inter-disiplinare e programit;

- Mungon një lëndë që fokusohet tek shkencat politike dhe politika ndërkombëtare;
- Politikat publike të BE-së dhe jo vetëm institucionet e saj të cilat në një pjesë të gjerë duhet të studiohen në nivelin Bachelor;
- Disa lëndë siç janë roli i OKB, zgjidhja e krizave ndërkombëtare apo marrëdhëniet ndërkombëtare pas luftës së ftohtë janë cilësuese dhe është më mirë të zhvendosen në vitin e dytë për ti lënë vendin në vitin e parë lëndë më themeltare siç janë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare.

Për të vlerësuar cilësinë e teksteve mësimore që ka përdorur institucioni në kuadrin e lëndëve të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë marrë në shqyrtim silabuset e depozituara të lëndëve si dhe takimet në institucion me drejtuesit, personelin akademik dhe studentët. Ndonëse përmenden disa tekste kryesore, në silabuset e disa prej lëndëve të zhvilluara në këtë program, mungon përgjithësisht literatura cilësore (tekset janë përgjithësisht të publikuar përpara një dekade ose më herët si dhe kryesisht të bazuar në autorë vendas). Në silabuse të tjerë nuk përmenden fare autorë të huaj dhe/ose mungojnë datat e publikimit të librave. Ndërsa në një rast (në Syllabusin e Përgjegjësit të Departamentit PhD Edon Qesari dhe Doktorantit Dritan Hoti), në lëndën: “Marrëdhëniet Ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë”) mungon tërësisht literatura bazë dhe ajo ndihmëse mbi të cilën bazohet lënda, çka i vendos studentët përpara mungesës së informacionit mbi literaturën dhe mund të çënojë procesin e përfutimit të dijeve nga lënda.

Rekomandim: Rekomandohet plotësimi i silabuseve sipas një standardi të vetëm të unifikuar, ku të dalin qartë dijet e synuara dhe/ose ato të përfutura nga studentët në përfundim të çdo lënde, me literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore.


- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Formular për praktikën mësimore
 - Planet mësimore 2012-2017 (stafi i lidhur me lëndët)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Në bazë të informacionit të prezantuar dhe prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Në bazë të informacionit të prezantuar dhe prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, një student që ndjek programin me kohë të plotë mund të grumbullojë gjatë një viti mesatarisht 60 kredite.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale,</p>	<p>Pavarësisht aspekteve të cilat mund të përmirësohen më tej, nga studimi i syllabuseve të paraqitura dhe nga përshkrimet e moduleve, ky master ofron njohuri më të thelluara se programi Bachelor. Organizimi i moduleve me detyra kursi, përgatitje prezantimesh apo aktiviteteve të brain-storm gërsheton edhe aspektin praktik të programit. Më shumë mbetet për tu bërë në këtë drejtim për institucionlizimin e mundësive për kryerjen e praktikës së programit pranë institucioneve apo organizmave të specializuara në këtë drejtim.</p> <p>Tematika e moduleve dhe përmbajtja e tyre në shumicën e rasteve është një hap cilësor më tej përsa i takon njohurive të fituara gjatë programit bachelor. Edhe në këtë rast ka disa aspekte (shih rekomandimet më sipër) të cilat mund të përmirësohen duke kaluar një pjesë të tematikave të disa moduleve në nivelin bachelor.</p> <p>Vendosja e një moduli për metodat e kërkimit shkencor si edhe mjaft aspekte të punës që i kërkohet të bëjnë studentëve brenda kursit por edhe në punën për përgatitjen e tezës së masterit, i pajis studentët me mjetet e nevojshme metodologjike për të vazhduar më tej në karrierën akademike.</p>
<p>të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive</p>	<p>Në strategjinë e programit nuk është paraqitur në mënyrë të qartë një lidhje midis çdo objektivit të programit, kurrikulës dhe synimit përfundimtar të programit. Megjithatë, materiali që ofrohet nga ana akademike përmban një nivel të kënaqshëm të njohurive. Kriteri përmbushet nga ana e tematikave</p>

<p>me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arrijtet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>studimore por jo nga mënyra e renditjes së objektivave. Metodat e ndryshme të vlerësimit që aplikohen në program, shpërndarja dhe frekuenca e tyre, si dhe harmonizimi i elementëve të ndryshëm në vlerësimin përfundimtar dëshmojnë në mënyrë të saktë njohuritë e fituara nga studentët gjatë vitit.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Informacioni i ofruar si nga RVB por edhe nga dokumentacioni i paraqitur lidhur me bashkëpunimin me institucionet akademike ndërkombëtare nuk ofron një argumentim të qartë në këtë drejtim. Programi mësimor është përgjithësisht aktual në krahasim me vendet e tjera por mënyra se si argumentohet kjo është e përgjithshme dhe pa ilustruar konkretisht. Informacioni lidhur me vlerën ndërkombëtare të programit të paraqitur është i përciptë dhe nuk ofrohen referenca mbi programet ndërkombëtare të shfrytëzuara për ndërtimin e masterit. Pranimi i studentëve në program është parashtruar tek rregullorja e programit të studimit. Kreditet, kriteret e vlerësimit apo të tjerë komponentë janë në përputhje me praktikën evropiane.</p> <p>Lidhur me faktin nëse programi i studimeve është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, informacioni i paraqitur nuk ofron të dhëna lidhur me këtë aspekt ndonëse informacionet e ofruara në të tjera seksione të vlerësimit dhe dokumentat e bashkëngjitura tregojnë se lidhur me aspektet formale, programi është hartuar në përgjithësi në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik</p>	<p>Programi akademik dhe format e aplikimit gjatë ushtrimit të tij mundësojnë aftësimin e studentëve. Megjithatë mungon një informacion i saktë mbi aftësimin profesional të studentëve sidomos lidhur me praktikën mësimore.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me ligjet dhe dispozitat në fuqi të Ministrisë së Arsimit. Një argumentim më i plotë i hartimit të tij në përputhje me strategjinë e UMSH nuk është ofruar.</p> <p>Informacioni që spjegon angazhimin e personelit akademik pranë këtij programi në punime kërkimore</p>



<p>të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>dhe shkencore tregon për një numër botimesh prej 29 brenda vendit 9 jashtë vendit dhe 8 monografi. Po kështu ka një pjesëmarrje në 41 konferenca të organizuara jashtë vendit. Megjithatë si në rastin e botimeve ashtu edhe në pjesëmarrjen në konferenca shkencore, informacioni nuk është i detajuar në vite, (për të parë nëse është gjatë vitit të fundit, viteve që i takojnë akreditimit apo përbën të gjithë botimet e pedagogëve që marrin pjesë në program) dhe as në tematikë. Nuk jepet gjithashtu një shpjegim lidhur me tematikat e botimeve dhe kombinimin e tyre me programet e studimeve.</p> <p>Argumentimi i mësipërm vlen edhe për ata që takon punës kërkimore të zhvilluar nga personeli i angazhuar në programin e studimeve në përputhje me objektivat dhe synimet akademike të programit.</p>
--	---

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
---	------------

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Pas vizitës në institucion, UMSH ka paraqitur një dokument i cili analizon në një mënyrë të përgjithshme kërkesat e tregut të punës por nuk është një studim i dedikuar për këtë program. Vetëm përciptas citohen nevojat e paraqitura nga institucionet qëndrore ku theksohet se pothuajse gjysma e nëpunësve nuk kanë arsimin e nevojshëm, në profilin e këtij masteri. Për më shumë nuk ka një numër qoftë edhe të përafërt të nevojave ndërsa nuk bëhet një analizë e konkurrentëve në tregun e edukimit si edhe të evidentohet USP (Unique Selling Proposition) e këtij programi.</p>
---	---

Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Në informacionet e ofruara në RVB dhe duke konsideruar rolin e këtij masteri në përpjekjet për të përgatitur kuadro të aftë për përsheptimin e integritit evropian të vendit, mendojmë se programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Megjithatë si në RVB ashtu edhe dokumenta të tjera të vëna në dispozicion nuk paraqitet asnjë e dhënë lidhur me mënyrën se si programi ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore dhe kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i paraqitur realizohet nëpërmjet 120 ECTS me një kohëzgjatje prej dy vitesh akademike dhe me një program teze dhe praktikë kërkimore të barasvlefshme me 35 ECTS.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Në informacionin e ofruar nënvizohet se programi mësimor dhe syllabus është i konsultueshëm online. Megjithatë nga një kërkim në faqen e internetit nuk mund të gjendet syllabus dhe modulet e kursit, çka do të thotë që së paku programet e studimeve nuk janë lehtësisht të konsultueshme.</p> <p>Informacioni i programit nuk është i konsultueshëm në formën elektronike ndërsa mund të konsultohet në formën e shkruar.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Plani mësimor i prezantuar në program është i qartë dhe organizimi i ngarkesës mësimore krijon mundësi për diplomimin e studentit brenda afatit të parashikuar.</p>
<p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Në programin e paraqitur janë parashikuar 35 kredite për realizimin e projektit kërkimor dhe të tezës.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentacioni i prezantuar është i pjesshëm dhe disa herë i paqartë. Nuk janë kërkuar apo përgatitur informacionet dhe të dhënat e nevojshme të kërkuara nga RVB. 2. Programi plotëson kriteret që lidhen me aspektet ligjore dhe përmbushjen e dispozitave përkatëse të përcaktuara. 	

3. Nuk argumentohet se si niveli shkencor i pedagogëve (botimet, pjesëmarrjet në konferenca, etj) ndikojnë në rritjen e nivelit shkencor të masterit. Informacioni i paraqitur nuk ofron informacion lidhur me frekuencën e këtyre botimeve (nëse janë publikuar vitin e fundit apo janë të gjitha botimet që kanë publikuar pedagogët e programit), tematikat e tyre dhe faktorin e organeve akademike pranë të cilave janë botuar.
4. Përsa i përket organizimit të lëndëve gjatë viteve, syllabuseve dhe tematikave të tyre mund të themi se:
 - i) Nuk ka një organizim interdisiplinor të programit pasi mungon një lëndë që fokusohet tek shkencat politike dhe politika ndërkombëtare.
 - ii) Ka një disbalancë midis lëndëve formuese dhe atyre cilësuese në favor të të dytës.
 - iii) Shpërndarja në të dy vitet nuk është bërë në mënyrë harmonike duke ndjekur procesin e krijimit të bazës së njohurive dhe pastaj thellimit të tyre në drejtime të përcaktuara. Disa lëndë siç janë roli i OKB, zgjidhja e krizave ndërkombëtare apo marrëdhëniet ndërkombëtare pas luftës së ftohtë janë cilësuese dhe është më mirë të zhvendosen në vitin e dytë për ti lënë vendin në vitin e parë lëndëve më themeltare siç janë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare (e cila zhvillohet në vitin e dytë).
 - iv) Politikat publike të BE-se dhe jo vetëm institucionet e saj në një pjesë të gjerë, duhet të studiohen në nivelin Bachelor, ndërsa në nivelin master duhet më tepër fokusim tek politikat e BE-së dhe analiza e tyre.

Standardet plotësohen pjesërisht.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në programin e studimit Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare vihet re se mësimdhënia bazohet në një kurrikulë me lëndë të veçanta, të miratuara që në hapjen e programit. Nuk konstatohen ndryshime të tjera në lëndë pas miratimit të kësaj kurrikule dhe për periudhën që merr në shqyrtim ky proces ri-akreditimi, përveç lëndës së zhvilluar në gjuhën angleze: “Marrëdhëniet Ndërkombëtare – International relations”. Konstatohet se mësimdhënia ndahet përgjithësisht në dy kategori, në varësi dhe të llojit të lëndës: leksione dhe seminare. Megjithatë sipas RVB si forma të mësimdhënies për këtë program studimi përmendet edhe praktika profesionale dhe orët e konsultimit me studentët, të cilat janë të përjavshme. Por këto nuk mund të jenë mënyra mësimdhënieje në kuptimin metodologjik dhe përmbajtësor. Ngarkesa në auditor realizohet në trajtën e leksioneve dhe seminareve. Ngarkesa specifike e pedagogëve konstatohet se është kryer në përputhje me kualifikimet e pedagogëve, ndërsa, siç është konstatuar më lart në këtë raport, ka nevojë në vijim për një përputhshmëri më të mirë të profilit shkencor/akademik të pedagogëve me lëndët që ata japin në nivelin e Masterit Shkencor. Gjithashtu ka shpërndarje të ngarkesës së lëndëve të tyre nëpër semestra. Për lëndët me karakter më praktik/aplikativ, vërehet se pesha bie më shumë në metoda më aplikative të

mësimdhënies, të pasuruara me raste studimore. Bazuar në RVB dhe në takimet e zhvilluara në institucion, metoda e mësimdhënies konstatohet se është interaktive. Kjo përputhet me natyrën shkencore të nivelit master, duke i bërë studentët pjesë të analizës dhe interpretimit të fenomeneve të marrëdhënies ndërkombëtare. Interaktiviteti realizohet nëpërmjet rasteve studimore, ndarjes së punës në grup, prezantimeve të çështjeve specifike, etj. Metoda të tjera të mësimdhënies përfshijnë simulime rastesh, ndarje në grup dhe “brainstorming”, interpretim analitik, prezantime, hulumtime të orientuara që referohen më pas në klasë, etj. Nga pikëpamja teknologjike vërehet përdorimi i prezantimeve dhe i shfaqjes së materialeve audiovizuale që i ndihmojnë studentët të familjarizohen me subjektin e analizës. Studentët e Masterit Shkencor konstatohet se janë përfshirë në aktivitete shkencore, si Panairi i Ideve, apo edhe veprimtari të tjera shkencore brenda departamentit (konferenca, simpoziume) me punime të tyre. Megjithatë kjo është intensifikuar gjatë dy viteve të fundit akademik.

Studentët konstatohet se kanë mundësi të vlerësojnë mësimdhënien nëpërmjet vlerësimit të çdo lënde. Forma të tjera vlerësimi të brendshëm përfshijnë “vizitat në auditor” nga përgjegjësi i Departamentit të Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, të pasuara nga vërejtje, sugjerime dhe analiza për pedagogë dhe lëndë të caktuara.

Një konstatim tjetër lidhet me mungesën e lëndëve opsionale. Shpjegimi i Përgjegjësit të Departamentit ishte se kjo çështje do të rishikohet me integrimin e Marrëdhënies Ndërkombëtare brenda Fakultetit Juridik, pasi më parë lëndët opsionale nuk kishin numrat e nevojshëm të studentëve për frekuentim.

Në këto kushte sugjerohet përfshirja më aktive e studentëve në punimet shkencore të pedagogëve dhe departamentit. Një sugjerim tjetër lidhet me ndërtimin e një sistemi të brendshëm anti-plagjiaturë, ndryshimin sistematik (çdo vit) të temave të eseve që u jepen studentëve dhe mënjanimin e temave të lira të eseve (për sa kohë kjo nuk çënon lirinë akademike dhe kërkimore të studentëve).


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (*Tabela 14 në Aneksë*)

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive (*Tabela 15 në Aneksë*)

Forma e kontrollit të njohurive për lëndët e Masterit Shkencor të Marrëdhënies Ndërkombëtare përfshijnë disa komponentë: pjesëmarrjen (10%); detyrat e kursit (të cilat për këtë nivel studimor konstatohet se janë Ese Kërkimore) (20%); testimet e ndërmjetme (10%); dhe provimin përfundimtar (60%). Nga konstatimi gjatë vizitës rezulton se kjo nuk është forma



e vetme e vlerësimit të lëndëve, pasi disa lëndë kanë vlerësim më të madh të testimeve të ndërmjetme. Ndërsa për detyrat e kursit, pavarësisht se studentët rezultojnë të paralajmëruar nga pedagogët e lëndëve përkatëse lidhur me pasojat akademike në rastin e plagjiaturës, nuk ekziston një sistem/iniciativë anti-plagjiature, i cili të jetë i ndërtuar në bazë universiteti.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj. (Tabela 18 në Aneksë)

Konstatohet se përfshirja e studentëve specifikisht për programin e Masterit të Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, në aktivitetin shkencor të institucionit realizohet për projekte shkencore në rang departamenti dhe fakulteti (me 46 angazhime të tilla). Studentët konstatohet se janë përfshirë në Panairin e Ideve që mbahet çdo vit në formën e një konference studentore me ide shkencore.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore


Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Konstatohet se kriteret që ekzistojnë për pranimin e studentëve në Masterin Shkencor të Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë (Ligji 80/2015). Nga verifikimi i studentëve të pranuar rezultojnë se ata kanë përfunduar të gjithë sistemin Bachelor duke grumbulluar 180 ECTS.

Nuk rezultojnë kriteret tjerë specifikë të pranimit në programin Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, përveç atij të diplomës së gjuhës së huaj. Gjuha e huaj (njohja e një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Evropian) rezultojnë kriter ligjor i regjistrimit në hyrje në këtë program. Megjithatë kriteret janë shumë të përgjithshme, çka ka bërë që studentët që frekuentojnë këtë program të kenë një mesatare rreth 7-8 (notë mesatare në hyrje), e cila potencialisht ndikon në cilësinë e tyre. Siç rezultojnë edhe nga të dhënat më poshtë, kjo mesatare përgjithësisht ruhet edhe në dalje. Gjithashtu kriteri i njohjes paraprake i gjuhës së huaj, sidomos në këtë nivel, përmirëson aftësinë e studentëve për të përvetësuar dhe shfrytëzuar literaturën në gjuhët e huaja dhe forcon kapacitetet e tyre të kërkimit shkencor.

Nga ana tjetër, konstatohet se institucioni i ka përcaktuar kriteret e pranimit në ciklin e dytë të studimeve në përputhje me mundësitë akademike dhe nevojat e tregut. Mundësitë akademike janë në përputhje me kapacitetet njerëzore (pedagogë me grada shkencore), ndërsa kapacitetet në përputhje me nevojat e tregut janë përcaktuar bazuar në një studim tregu, të kryer për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit (sipas dokumentit: “Vëzhgim mbi Nevojat e Tregut të Punës për Hapjen e Programeve BA dhe Master në SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” UMSH).

Nga një vështrim më statistikor i të dhënave të paraqitura dhe i atyre të konstatuara nga vizita në institucion:



- i) Numri i studentëve në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2012-2013 ishte 40, me një mesatare në hyrje 7.8 dhe në dalje përsëri 7.8. Numri i të diplomuarve të këtij cikli ishte 22.
- ii) Numri i studentëve në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2013-2014 ishte 32; mesatarja në hyrje ishte 8.1, ndërsa në dalje 7.8. Numri i të diplomuarve të këtij cikli ishte 41 (pasi këtij numri i shtohen dhe diplomimet e viteve të mëparshëm).
- iii) Numri i studentëve të rinj në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2014-2015 ishte 30; mesatarja në hyrje ishte 7.6, ndërsa në dalje 7.8. Numri i të diplomuarve të këtij cikli ishte 24.
- iv) Numri i studentëve në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2015-2016 ishte 35; mesatarja në hyrje ishte 7.8, ndërsa në dalje 7.5. Numri i të diplomuarve të këtij cikli ishte 25.
- v) Numri i studentëve në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2016-2017 ishte 28; mesatarja në hyrje ishte 7.9.
- vi) Numri i studentëve në hyrje të regjistruar gjatë vitit akademik 2017-2018 ishte 30; mesatarja në hyrje ishte 6.85 (mesatarja më e ulët për vitet e regjistruara).

Kalueshmëria e studentëve është rreth 50-60% - pra afërsisht një në dy studentë arrijnë ta mbyllin këtë cikël studimesh brenda kohës dy-vjeçare të studimeve. Ndërkohë koha mesatare e zgjatjes së studimeve rezulton afërsisht 2.5-3 vite akademike (mesatarja e saktë është praktikisht e pamundur të llogaritet, për shkak të lëvizshmërisë së studentëve të diplomuar brenda këtij harku). Në çdo rast, koha maksimale e diplomimit të studentëve nga ky program Masteri Shkencor nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve (dy vite akademike).

Vlerësimi i treguesve të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Sa i takon kushteve/procedurave të përgjithshme të pranimit të studentëve, konstatohet se regjistrimi i tyre në këtë program Masteri bazohet në legjislacionin në fuqi, Statutin e institucionit dhe udhëzimet e Rektoratit. Procedura e pranimit përfshin regjistrimin në sekretarinë mësimore, plotësimin e dosjes së studentit, pagesën e tarifës dhe kontratën e studimit. Gjithashtu rregullorja parashikon edhe kushtet kur një student humbet të drejtën e studimit në këtë program dhe përjashtohet prej tij.

Sa i takon kushteve specifike, ato specifikohen në Nenin 51 të Rregullores, sipas të cilës kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet Bachelor të ciklit të parë si dhe të kenë mbrojtur një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian. Të dyja këto janë kushte ligjore.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Konstatohet se mesatarja e studentëve në hyrje dhe në dalje është ruajtur përgjithësisht gjatë të gjithë viteve për të cilët janë pasqyruar të dhënat. Të dhëna më të detajuara jepen në Tabelën 16 të Anekseve.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Nga të dhënat e ofruara prej institucionit dhe verifikimi i regjistrimit themeltar pranë sekretarisë mësimore, konstatohet se në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 30 studentë me një notë mesatare 6.86. Të dhëna më të detajuara jepen në Tabelën 16 të Anekseve.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Numri i studentëve të diplomuar vitin e fundit (2015-2017) pa vite përsëritëse ishte 25 me notë mesatare në hyrje 7.8 dhe në dalje 7.5.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend (*Tabela 16 e Anekseve*)

Ky program masteri ka një mobilitet në hyrje të luhatshëm në vite, nga 13 studentë në total në vitin akademik 2013-2014; në 49 studentë në vitin akademik 2014-2015 (numri i lartë i atribuohet mbylljes së një numri IAL në këtë vit); në 10 studentë gjatë vitit akademik 2015-2016; 5 për vitin 2016-2017; dhe 3 për vitin 2017-2018.

Të dhëna për punësimin e studentëve (*Tabela 17 e Anekseve*)

Bazuar në të dhënat e RVB-së, 67 nga 119 e të diplomuarve janë punësuar në përputhje me diplomën, 44 të tjerë janë punësuar në profile të tjera pa përputhje me profilin e studimeve, kurse pjesa tjetër nuk janë të punësuar. Vitin e kaluar në UMSH është themeluar organizata e studentëve të diplomuar, ALUMNI, e cila shërben si një instrument lobimi për të gjithë ish-studentët dhe promovimin e rrjetit të tyre në tregun e punës. Ka nevojë megjithatë që ALUMNI si organizatë e ish-studentëve të forcohet më tej dhe të konsolidohet, pasi jo të gjithë studentët e programit të Master-it ishin në dijeni të ALUMNI-t dhe funksioneve që ajo kryente në shërbim të komunitetit të të diplomuarve nga institucioni. Sugjerohet që ALUMNI të mbajë takime të përvitshme ku të bashkohen të gjithë studentët e diplomuar nga të gjitha programet e studimit.

Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve për këtë program studimi gjatë periudhës 2012-2018 është 119.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

67 nga 119 të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

44 nga 119 të diplomuar janë punësuar në profile të tjera pa përputhje me profilin e studimeve.

Gjendja e konstatuar në institucion përputhet përgjithësisht me të dhënat e deklaruara nga institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Megjithatë një numër i vogël ndryshimesh të kërkuara nga GVJ gjatë procesit të shqyrtimit të të dhënave u pasqyruan në tabela nga Institucioni duke i përditësuar dhe dorëzuar ato. Këto ndryshime të evidentuara nuk ndikojnë gjithsesi në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Aplikim për ndihmë financiare
 - Të dhëna për studentët ndër vite
 - Saktësim i tabelës 17

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program Masteri zotërojnë minimalisht diplomën Bachelor (dhe kanë siguruar të paktën 180 ECTS), prandaj ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Konstatohet se të gjithë studentët janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore.</p> <p>Rezulton se kriteret e vetme të regjistrimit që aplikon institucioni janë ato ligjore. Këto kriteret dhe standarde respektohen plotësisht.</p> <p>Sa i takon kriterit që lidhet me gjuhën angleze, procedurat e pranimit në këtë program masteri parashikojnë në mënyrë eksplicite (Aneksi 4 i rregullores së programit të studimit të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare) mbrojtjen e një prej pesë gjuhëve të BE-së, përfshirë dhe anglishten. Ky kriter i anglishtes plotësohet nëpërmjet marrëveshjes UMSH-STA (TOEIC) për studentët që regjistrohen në këtë program. Përveç kësaj studentët zhvillojnë edhe një lëndë në këtë master në gjuhën angleze, të quajtur “Marrëdhënie Ndërkombëtare” (International Relations). Studentët u shprehën se kjo lëndë u ka shërbyer për të forcuar njohuritë e studentëve mbi</p>

	<p>marrëdhëniet ndërkombëtare edhe në gjuhën angleze.</p> <p>Gjithashtu u konstatuan edhe kritere të tjera të përzgjedhjes, si komisioni i ngritur nga Dekani i Fakultetit, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe dosjet personale të kandidatëve për këtë program.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Konstatohet se pranë institucionit është ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës së studentëve, që mbështet studentët gjatë dhe pas studimeve, duke i orientuar në raport me tregun e punës. Kjo zyrë ka krijuar 3 vitet e fundit një databazë me studentët që janë diplomuar dhe ka identifikuar hapat e para të karrierës/punësimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	<p>Konstatohet nga takimi me këtë zyrë se studentët marrin këshillimin e karrierës në mënyrë të vazhdueshme.</p>
<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>Institucioni disponon dhe ka vendosur në dispozicion të GVJ-së statistika vjetore dhe periodike të numrit të të regjistruarve dhe diplomuarve. Këto statistika konstatohet se janë të plota dhe përmbajnë informacione të vlefshme për qëllimet e këtij raporti.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>Konstatohet se institucioni disponon statistika vjetore të numrit të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë si dhe statistika të të gjitha lëvizjeve përpara përfundimit të programit. Konstatohet gjithashtu se institucioni disponon të dhëna të plota për ecurinë e studentëve, që nga pranimi deri në diplomim.</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, në sekretarinë mësimore, u evidentua një mospërputhje midis numrit të studentëve në regjistrin themeltar të programit dhe</p>

	regjistrit në auditor, për të cilën Institucioni deklaron se në regjistrin e lëndës evidentohen vetëm studentët të cilët regjistrojnë semestrin/vitin akademik si dhe një mospërputhje u midis numrit të studentëve të deklaruar në RVB dhe numrit të studentëve sipas regjistrit themeltar, sipas tabelës 16 të Anekseve.
--	--

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Konstatohet se institucioni ka krijuar një bazë të dhënash për këtë program studimi për punësimin e studentëve, sipas numrit total të të diplomuarve, të diplomuarve në përputhje me diplomën dhe numrin e të punësuarve jo në përputhje me diplomën. Këta numra janë: 119 të diplomuar në total, 67 të punësuar në përputhje me diplomën, 44 të punësuar jo në përputhje me diplomën dhe 8 të diplomuar të papunësuar.</p> <p>Gjithashtu nga takimi me studentët dhe zyrën e karrierës dhe kujdesit për studentin u konstatua se ekzistonin raste të studentëve që kanë vijuar më tej studimet, brenda ose jashtë vendit.</p>
--	---

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Konstatohet se ky standard përmbushet plotësisht. Studentët janë të informuar rreth programit, mundësive të punësimit për këtë disiplinë, strukturën e kurrikulës dhe procesin e akreditimit.</p> <p>Gjithashtu vlerësimet e studentëve janë transparente dhe atyre u jepet mundësia të ballafaqohen me pikët e marra në testime apo ese. Kjo transparencë është reale dhe në funksion të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes së studentëve.</p> <p>Konstatohet gjithashtu nga bashkëbisedimi me studentët në institucion se ata kanë mundësinë të vlerësojnë pedagogët e tyre dhe se vlerësimet janë marrë parasysh prej tyre</p>
---	---

	dhe prej vetë institucionit, si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të performancës së stafit akademik.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Gjithashtu atyre u jepen edhe mundësi të zhvillimit të praktikave, për të cilat konstatohet ekzistenca e një rregulloreje të procedurës, si dhe ndjekja e praktikës pranë institucioneve.</p> <p>Praktikat ndiqen nga një prej pedagogëve të departamentit, në grupe të vogla. Praktikrat e studentëve zhvillohen në institucione publike (Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, etj.) dhe në organizata ndërkombëtare. Këto rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara. Gjithashtu praktikrat kryhen edhe në organizata joqeveritare, si fondacioni Friedrich Ebert Stiftung, Konrad, etj. Megjithatë konstatohet se në MPJ dhe në organizatat e tjera të përmendura nuk ka pasur studentë në praktikë.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësohet se institucioni ka përmbushur detyrimet për të krijuar një bazë të dhënash për këtë program studimi lidhur me punësimin e studentëve. 2. Vlerësohet se institucioni ka përmbushur detyrimet për të ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës së studentëve në mbështetje të studentëve gjatë dhe pas studimeve. Kjo tregon se institucioni i ka kushtuar rëndësi të veçantë informimit të studentëve për programet, karrierën dhe tregun e punës. 3. Vlerësohet se institucioni disponon statistika vjetore dhe periodike të numrit të të regjistruarve dhe të të diplomuarve. 4. Vlerësohet se të gjithë studentët janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore. Gjatë vizitës në Institucion, në sekretarinë mësimore, u evidentua një mospërputhje midis numrit të studentëve në regjistrin themeltar të programit dhe regjistrin në auditor, për të cilën Institucioni deklaroi se në regjistrin e lëndës evidentohen vetëm studentët të cilët regjistrojnë semestrin/vitin akademik si dhe një mospërputhje u midis numrit të studentëve të deklaruar në RVB dhe numrit të studentëve sipas regjistrin themeltar. 5. Vlerësohet se institucioni ka themeluar organizatën e studentëve të diplomuar, ALUMNI, një mjet lobimi për të gjithë ish-studentët dhe promovimin e rrjetit të tyre në 	

tregun e punës.

6. Vlerësohet se institucioni ka garantuar transparencën e vlerësimeve të studentëve.
7. Sugjerohet që ALUMNI të mbajë takime të përvitshme ku të bashkohen të gjithë studentët e diplomuar nga të gjitha programet e studimit.

Standardet plotësohen plotësisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.


Institucioni ka ngritur ndër vite disa struktura të kërkimit shkencor, funksionimi dhe organizimi i të cilave përcaktohet nga politikat institucionale dhe mbështetet në rregullore, statut dhe aktet e tjera rregullatore. UMSH ndjek politika specifike dhe bashkëpunon për kërkimin shkencor me faktorë të jashtëm e të brendshëm në mënyrë të institucionalizuar me marrëveshje ose në mënyrë individuale e në grup midis stafit akademik dhe institucioneve të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në nivel institucional ekziston një ndarje e kërkimit shkencor midis Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Qendrës së Projekteve.

Zyra e Kërkimit Shkencor është përgjegjëse për financimin e kërkimit shkencor, përmes një procedure që buron nga çdo anëtar i stafit akademik dhe kalon përmes departamentit dhe dekanatit, deri tek Zyra e Financës së UMSH-së. Nga ana tjetër Qendra e Projekteve është përgjegjëse për aplikimet dhe implementimin e projekteve shkencore. Ajo e ka filluar veprimtarinë e saj vetëm gjatë vitit akademik 2017-2018. Deri tani raportohet se është aplikuar për 13 projekte, 3 prej të cilëve janë fituar.

Në nivelin e departamentit, e konkretisht të atij të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kërkimi shkencor ka dy forma: a) ai realizohet në nivel individual dhe me llogaridhënie periodike (ose një herë në vit); b) kërkimi shkencor realizohet edhe në nivel grupi nëpërmjet: i) konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit; ii) botimeve në revista shkencore me bord shkencor, brenda dhe jashtë (me faktor impakti dhe/ose bord shkencor); iii) bashkëpunimeve midis organizmave publikë dhe jo-publikë. Kjo i jep vlerësimin të punës shkencore dy komponentë: cilësor (revista me faktor impakti) dhe sasior (numër botimesh).

Në nivelin e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, konstatohet gjithashtu se kërkimi shkencor konsiderohet si përmbledhje e të gjitha kontributeve shkencore të pedagogëve. Vetë departamenti nuk është përfshirë ndonjëherë në projekt kërkimi shkencor, por ai kryhet nga individë brenda departamentit (shembujt e konstatuar përfshijnë pedagogët: Nevila Rama, Kriton Kuçi, Edon Qesari, etj).

Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien për programin e Masterit Shkencor të Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbën një nga prioritetet kryesore. Ai kryhet përmes përfshirjes së studentëve në Konferenca Shkencore (si Panairi i Ideve) dhe stafit akademik në



botime dhe konferenca. Kualifikimi i stafit akademik ndikon drejtpërdrejt në nivelin e mësimdhënies dhe të literaturës së përdorur.

UMSH ndjek politika të inkurajimit të pjesëmarrjes së stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore, duke siguruar gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe duke mundësuar shkëmbime eksperiencash, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Që prej 2009 UMSH është anëtar i EMUNI (Euro-Mediterranean University) dhe anëtar i EURAS (që prej vitit 2010). Por në RVB nuk del qartazi në pah si kanë kontribuar konkretisht këto dy rrjete në fuqizimin e kërkimit shkencor në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (*Tabela 19 e Anekseve*)

Konstatohet se të dhënat e vendosura në dispozicion janë të përgjithshme dhe nuk lidhen në mënyrë të veçantë me punën shkencore në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare apo programin e Masterit Shkencor të marrë në shqyrtim.

Numri i botimeve nga PAE i IAL-së është 949, ndërsa projektet kërkimore të fituara (vetëm gjatë vitit të fundit) janë 3. Të treja këto projekte janë aktualisht në fazën e zbatimit. UMSH ka qenë aktiv edhe sa i takon aktiviteteve shkencore, me 7 të tilla dhe me numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish, 532. Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 174, i bazuar sidomos në Panairin e Ideve, një konferencë studimore studentore, e organizuar çdo vit gjatë tre viteve të fundit.

Konstatohet se të dhënat nga RVB përputhen kryesisht me gjendjen e konstatuar në institucion. Kështu, analiza në nivel departamenti tregon se kërkimi shkencor ka dy forma: a) individual me llogaridhënie periodike; dhe b) në nivel grupi nëpërmjet konferencave shkencore (rrjeti EMUNI konstatohet si shumë aktiv në organizime të tilla); botimeve në revista shkencore me bord shkencor; iii) bashkëpunimeve midis organizmave publikë dhe jo-publikë. Kjo i jep vlerësimi të punës shkencore dy komponentë: cilësor (revista me faktor impakti) dhe sasior (numër botimesh). Në nivelin e departamentit konstatohet se kërkimi shkencor konsiderohet përmbledhje e kontributeve shkencore. Vetë departamenti nuk është përfshirë ndonjëherë në projekt kërkimi shkencor, por kjo zhvillohet nga stafi. Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien kryhet përmes përfshirjes së studentëve në Konferenca Shkencore si Panairi i Ideve dhe stafit akademik në botime dhe konferenca.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Raport mbi angazhimin e UMSH në projekte
 - Përmbledhje e punës shkencore-kërkimore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Konstatohet se standardi i botimeve të artikujve shkencorë plotësohet. Personeli akademik i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është angazhuar në publikime të artikujve dhe materialeve shkencore. Këto veprimtari përfshijnë konferenca shkencore dhe publikime periodike, si në revistën e vetë institucionit “Mesdheu” ashtu dhe në revista të tjera. Por nuk konstatohen publikime të stafit në revistat shkencore me faktor impakti Thomson Reuters ose Scopus.</p> <p>Personeli akademik është angazhuar nëpërmjet botimeve në interpretimin e proceseve të integritimit evropian, integritimit euroatlantik dhe politikës së jashtme e gjeopolitikës së Shqipërisë dhe rajonit me vlerësime të vlefshme shkencore.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Këto standarde plotësohen. Konstatohet se në programin e masterit në shqyrtim zhvillohet një lëndë për analizën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në anglisht.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Ky standard plotësohet plotësisht, pasi UMSH informon stafin akademik lidhur me mundësi studimi/kualifikime brenda dhe jashtë vendit. Institucioni e garanton pjesëmarrjen e stafit në këto aktivitete duke siguruar pozicionin e punës dhe ofrimin e lehtësirave të tjera. Aktualisht disa prej pjesëtarëve të stafit po kryejnë studimet doktorale brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Mbetet e paqartë se çfarë programesh specifike organizon vetë institucioni, përveç dhe përtej konferencave në nivel të përgjithshëm universitar.</p>

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Ndërsa institucioni ka vënë në dispozicion një bazë të plotë të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik në përgjithësi, ajo nuk ofron të dhëna për programin specifik të studimit që po ri-akreditohet.
Konstatohet se në bibliotekë ndodhej një databazë literature e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku përfshiheshin edhe kontributet shkencore/botimet e pedagogëve të departamentit.
Konstatohet se institucioni ka ende një sfidë të madhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore të vetë departamentit, ndonëse personeli akademik është përfshirë individualisht në projekte kërkimore-shkencore. Kjo do t'i jepte një hov cilësor kërkimit shkencor departamental.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Konstatohet se standardi i botimeve të artikujve shkencorë plotësohet. Personeli akademik i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është angazhuar në publikime të artikujve dhe materialeve shkencore.
2. UMSH informon stafin akademik lidhur me mundësi studimi/kualifikime brenda dhe jashtë vendit.
3. Ndërsa institucioni ka vënë në dispozicion një bazë të plotë të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik në përgjithësi, ajo nuk ofron të dhëna për programin specifik të studimit që po ri-akreditohet.
4. Institucioni ka ende një sfidë të madhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore të vetë departamentit, ndonëse personeli akademik është përfshirë individualisht në projekte kërkimore-shkencore.

Standardet plotësohen kryesisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Sikundër edhe theksuam në seksionin mbi përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm, bashkëpunimi me institucionet e tjera me disa përjashtime nuk është konkret dhe nuk përputhet me tematikën e këtij programi. Ka një sasi të madhe marrëveshjesh me institucione publike siç janë bashkitë, institucionet qendrore si Akademia Diplomatike e Ministrisë së Jashtme, Dhoma e Tregtisë, universitete të huaja si “London Academy of Diplomacy”, apo edhe me kompani dhe grupe të ndryshme biznesi. Por vetëm një pjesë e vogël e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me këtë program dhe kanë referenca konkrete ndaj tij. Megjithatë falë këtij bashkëpunimi ka një prezencë të kënaqshme të pjesëmarrjes së lektorëve të huaj në mësimet të hapura.

UMSH është anëtare i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS nëpërmjet të cilave është përparë për krijë marrëdhënie bashkëpunimi që nxisin shkëmbimin akademik, programet e përbashkëta dhe mobilitetin si të pedagogëve ashtu edhe të studentëve. Megjithatë, mobiliteti i personelit akademik dhe sidomos studentëve lë akoma për të dëshiruar dhe ka një pjesëmarrje relativisht të ulët në projekte ndërkombëtare siç janë Erasmus+ të cilat ndihmojnë për të rritur angazhimin dhe bashkëpunimin me partnerë akademikë ndërkombëtarë. Për momentin pjesëmarrja në programe ndërkombëtare është relativisht e ulët dhe informacioni i ofruar nuk paraqet një strategji të qartë për të spjeguar se si mund të kapërcehet kjo vështirësi.

UMSH ka një seri bashkëpunimesh me mjaft institucione dhe aktorë publikë dhe privatë siç janë Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë apo Dhoma Kombëtare e Avokatisë me të cilat ka hartuar edhe marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave mësimore apo edhe për të krijuar mundësi punësimi në të ardhmen. Megjithatë lidhjet me tregun e punës për programin në fjalë janë relativisht të pazhvilluara dhe nuk ka një rol të universitetit për të lehtësuar punësimin e studentëve nëpërmjet kontakteve institucionale të zhvilluara më parë me sektorë strategjikë për punësimin e studentëve të kësaj dege.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (*Tabela 20 e Anekseve*)

Në tabelen e paraqitur nga Institucioni nuk është sqaruar nëse të dhënat e prezantuara kanë të bëjnë me programin e paraqitur për akreditim apo me të gjithë insitucionin. Nga disa elementë në plotësimin e tabelës por edhe në krahasimin e bërë ndërmjet kësaj table dhe asaj të punimeve shkencore, duket se kjo tabelë i përket aktivitetit të të gjithë institucionit dhe jo të programit në fjalë. Në këtë mënyrë bëhet e vështirë analizimi mbi nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar të këtij programi. Vlejnë të theksohen këtu marrëveshjet e bashkëpunimit me një seri universitetesh apo qendrash kërkimore për studime mesdhetare por këto mbeten marrëveshje kuadër dhe nuk specifikojne nivelin apo programet konkrete të bashkëpunimit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (*Tabela 21 e Anekseve*)

Shumica e marrëveshjeve të bashkëpunimit të paraqitura në dokumentacionin bashkëngjitur nuk kanë lidhje direkte me programin e paraqitur për akreditim, siç janë marrëveshjet me bashkitë, me disa kompani apo institucione të cilat i shërbejnë dukshëm programeve të tjera të UMSH. Marrëveshjet me shumicën e universiteteve ndërkombëtare janë marrëveshje kuadër

dhe pa asnjë referencë për programin në shqyrtim, ndërsa disa nga marrëveshjet ose kanë përfunduar afatin ose nuk mbulojnë të gjithë periudhën 6 vjeçare të programit të paraqitur për akreditim (nga akreditimi i mëparshëm). Janë paraqitur edhe marrëveshje me kompani audiovizive apo të kontabilitetit që kanë një rol operacional ndoshta në menaxhimin e universitetit apo mbarëvajtjen e programeve të tjera por jo të programit në fjalë.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Informacion mbi aktivitetet e lidhura me marrëveshjet e bashkëpunimit (leksionet e hapura)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit të arritura me institucionet e tjera përfshijnë përgjithësisht edhe bashkëpunimin në fushën e praktikave mësimore. Në takimin me përfaqësuesit e programit gjatë vizites në institucion u theksua nga këta të fundit se në këto marrëveshje përfshihen edhe praktikat studimore.</p> <p>Siç theksohet edhe në paragrafin e parë të këtij raporti, marrëveshjet janë kuadër dhe pa asnjë referencë specifike për programin në fjalë. Edhe institucionet me të cilat janë lidhur këto marrëveshje për nga natyra e punës dhe objektivat e veprimtarisë së tyre nuk kanë asgjë të përbashkët me programin në fjalë. Ndonëse në disa raste si marrëveshja e bashkëpunimit me Akademinë e Diplomacisë pranë Ministrisë së Jashtme (përfunduar aktualisht afatin) apo me London Academy of Diplomacy, ndonëse nuk specifikohen detyrimet e fushat e bashkëpunimit, përsëri sigurohet një përputhshmëri midis objektivave të këtyre institucioneve dhe atyre të programit akademik.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe</p>	<p>Informacioni i vënë në dispozicion nuk ofrohen të dhënat e nevojshme për vlerësimin e realizimit të bashkëpunimit ndërmjet personelit të IAL-së. Si formë e vetme bashkëpunimi dhe shkëmbimi të informacionit paraqiten mbledhjet e departamentit dhe raportet e pedagogëve.</p>

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Në informacionin e paraqitur si nëpërmjet dokumentacionit por edhe vizitës në institucion spjegohen se si ndahen detyrat brenda personelit të institucionit, ndërmjet stafit akademik por edhe atij ndihmës dhe administrativ (<i>dokumenti mbi organizimin e institucionit</i>). Realizimi i përgjegjësive të marra bëhet nëpërmjet analizave të vazhdueshme për të parë ecurinë e programit dhe marrë masa korrigjuese në rast se është e nevojshme. Një shkëmbim i vazhdueshëm i eksperiencës me qëllim organizimin e punës shihet si një mekanizëm për të nxitur ndërmjet kolegëve marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
---	---

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka vendosur mjaft marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si edhe me aktorë institucionalë dhe të biznesit. Por shumica e këtyre marrëveshjeve janë kuadër dhe pa asnjë referencë ndaj programit në fjalë. Gjatë vizitës në institucion u kërkua dhe na u ofrua një listë e plotë me leksione të mbajtura nga pedagogë të huaj pranë UMSH. Megjithatë këto leksione të hapura përbëjnë vetëm një segment të bashkëpunimit i cili duhet të jetë shumëplanesh (si nga ana akademike ashtu edhe përsa i takon shkëmbimit të studentëve).</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ka një numër të madh marrëveshjesh kuadër me institucione publike, akademike dhe firma por këto janë marrëveshje kuadër të cilat krijojnë sasi por jo domosdoshmërisht cilësi.
2. Marrëveshjet e prezantuara në pjesën më të madhe nuk i referohen programit në fjalë dhe me përjashtimet e përmendura më lart i referohen marrëveshjeve të vlefshme për të gjithë IAL. Kjo nuk spjegon impaktin e këtyre marrëveshjeve në programin e marrë në shqyrtim.
3. Mbetet akoma për të bërë në drejtim të pjesëmarrjes në programe apo projekte ndërkombëtare nëpërmjet projekteve evropiane apo bashkëpunimit në programe mësimore (përfshirë masterin e marrë në shqyrtim) të përbashkëta me universitetet

ndërkombëtare.

Standardet plotësohen kryesisht.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

1. Lidhur me realizimin e rekomandimit **për ndërtimin e disa aspekteve të punës si “Zyra e Karrierës” dhe “Qendra e Kërkimit Shkencor”**, krijimi i Zyrës së Karrierës, e cila është profesionale dhe nën drejtimin e një profesori, është një hap pozitiv në lidhje me rekomandimet e ofruara ndërkohë që kjo zyrë mbante lidhjet me studentët në tregun e punës, ofronte mundësi për këta studentë, kryesisht nëpërmjet Alumni.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

2. Përsa i takon **rekomandimit mbi sigurimin e nje produkti konkret krahas marrëveshjeve të realizuara**, mund të themi se shumica e marrëveshjeve të bashkëpunimit të paraqitura nuk kanë lidhje direkte me programin e paraqitur për akreditim ose janë marrëveshje kuadër të cilat nuk ofrojnë një produkt konkret për këtë program studimi.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

3. Lidhur me zbatimin e kriterit **për azhornimin më të mirë me qendra të specializuara të Mesdheut duke azhornuar me to punën dhe kërkimin shkencor** ka një fokus relativisht të kufizuar në bashkëpunimin mesdhetar duke mos përfshirë të gjithë fokusin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Bashkëpunimi përqendrohet në dy drejtime: i) në zhvillimin e konferencave të përbashkëta; ii) në shkëmbimet e stafit akademik. Por siç shpjegoam kur analizuam realizimin e kriterit të mësipërm (marrëveshjet e bashkëpunimit), ka shumë pak syresh të cilat janë lidhur me qendra të cilat funksionojnë në fushën e specializimit të këtij masteri shkencor.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

4. Përsa i takon kriterit **mbi përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze për studentët e pranuar në këtë program studimi**, përveç përmbushjes së dispozitave ligjore, ka një hap pozitiv siç është marrëveshja që UMSH ka me STA për mundësinë e studentëve në dhënie të provimit të gjuhës angleze si edhe ofrimi i një lënde në gjuhën angleze.

GVJ vlerëson se rekomandimet janë përmbushur plotësisht.

5. Lidhur me rekomandimin e **mbajtjes në vëmendje në vitin e dytë MA praktikën dhe realizimin e tezës në mënyrë sa më serioze** në dokumentacionin e paraqitur theksohen bashkëpunimet me institucione dhe organizata të fokusuar në çështjet e integritimit



europian dhe mesdhetar. Megjithatë mungon një marrëveshje specifike e lidhur me këto institucione që ti referohet tezës finale, përveç disa marrëveshjeve kuadër me universitete të tjera.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

6. Përsa i takon rekomandimit lidhur me **sigurimin në kohën e duhur të programeve dhe kurrikulës së nivelit të doktoraturës** mund të themi se është planifikuar dhe vërtetuar si nga dokumentacioni ashtu edhe nga takimi i zhvilluar gjatë vizitës në institucion, hapja e programit të doktoraturës në vitin akademik 2018-2019.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Duke konsideruar tërësinë e rekomandimeve të marra në shqyrtim **GVJ vlerëson se rekomandimet janë përmbushur kryesisht.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Përmbushja e një pjese të rekomandimeve të dhëna nga akreditimi i mëparshëm, çka krijon mundësinë për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit në përgjithësi dhe programit në veçanti.
2. Institucioni ofron programe të cilat janë në përputhje me misionin e tij dhe strategjitë afatshkurtra dhe afatmesme të zhvillimit, si edhe një procedurë periodike për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve mësimore.
3. Strukturat ndihmëse dhe administrative japin një ndihmë pozitive në procesin e mësimdhënies dhe atij të kërkimit shkencor.
4. Programi mësimor paraqet një orientim të drejtë lidhur me larminë e metodologjive të zbatuara në punën dhe vlerësimin e studentëve.
5. Një harmonizim i punës ndërmjet pedagogëve të PAE dhe PAK si përsa i takon orëve të mësimdhënies ashtu edhe kompetencave mirë të ndërthurura.

b. Pika të dobëta:

1. Pamjaftueshmëri pune për ndërkombëtarizimin e programit me pjesëmarrjen si në projekte ndërkombëtare ashtu edhe në iniciativa të përbashkëta me universitete të huaja.
2. Mbetet shumë për tu bërë lidhur me rritjen e mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve. Ka vetëm 3 studentë nga i gjithë universiteti, të cilët kanë marrë pjesë në një program mobiliteti ndërkohë që nuk ka një informacion të tillë për pedagogët.
3. Nivel jo i mjaftueshëm si i inter-disiplinaritetit të programit ashtu edhe një organizim më të mirë për të patur lëndët formuese në vitin e parë dhe ato të specializuara në vitin e dytë.

4. Disa nga pedagogët janë përgjegjës për lëndë (sic është rasti i International Relations) për të cilat nuk kanë përputhje as në specializimin akademik dhe as në publikimet e paraqitura.
5. Publikimet e pedagogëve të programit janë të një niveli nën mesataren (sidomos i PAE të programit) si përsa i përket sasisë (vetëm disa botime në periudhën e akreditimit) ashtu edhe të cilësisë (nuk është e qartë nëse ndonjë nga këto artikuj është publikuar në revista me impact-factor).
6. Ka një hendek moshor ndërmjet gradave akademike sidomos përsa i takon PAE. Vihet re gjithashtu, një nevojë e ngutshme për të rritur nivelin akademik të PAE, megjithëse është në përmbushje të detyrimeve ligjore.
7. Ka një numër të ulët marrëveshjesh konkrete bashkëpunimi me institucione publike dhe private lidhur me praktikën e studentëve dhe mënyrat e ndjekjes së tyre nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucionet përkatëse.
8. Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe nevojave të tij për profesionistë në profilin e programit, çka vështirëson përputhjen në rritje të programit të ofruar me nevojat e tregut të punës. Megjithëse është e vështirë të gjenden shifra dhe të dhëna të tjera statistikore mund të ndërtohen proxy-indikatorë për të kuptuar nevojat e tregut të punës. Nuk ka një studim të tregut të ofertës nga të tjera universitete konkurruese për të kuptuar kush është unique selling proposition e programit të paraqitur. Duhet të kuptohet dhe shpjegohet qartë pse oferta e këtij programi është e veçantë nga universitetet e tjera dhe çfarë atributesh fitojnë studentët me përfundimin e këtij programi, të cilat i bëjnë ata më konkurrues në tregun e punës në krahasim me kolegët e tyre që përfundojnë studimet pranë institucioneve të tjera akademike.

c. Mundësitë:

1. Të përmirësohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit në RVJ të cilat janë plotësuar pjesërisht dhe të shikohen strategjitë për përmbushjen e kriterëve të cilat nuk janë përmbushur në këtë fazë.
2. Kurrikula akademike duhen rishikuar, duke konsideruar edhe nevojat që mund të kenë firmat apo institucionet shqiptare me integrimin e mëtejshëm në BE.
3. Rritja e publikimeve shkencore të stafit akademik sidomos përsa i takon tematikës së masterit të marrë në shqyrtim.
4. Shfrytëzimi i kontakteve dhe marrëveshjeve aktuale për të nënshkruar marrëveshje për të cilat ka nevojë programi në fjalë, si në aspektin e bashkëpunimit akademik ashtu edhe në atë të bashkëpunimit institucional për praktikën e studentëve.

d. Pengesat:

1. Një treg pune i kufizuar dhe me karakteristika mjaft specifike.
2. Procesi i ndërkombëtarizimit të institucionit kërkon një kohë të gjatë dhe prania aktualisht e kufizuar e institucioneve akademike shqiptare në bashkëpunimin evropian e më gjerë, nuk e përshpejton procesin.
3. Mungesa e kulturës nga ana e institucioneve dhe kompanitë shqiptare në trajtimin e studentëve që kryejnë praktikën pranë tyre si burime njerëzore profesionale.

Rekomandime:

1. Duhet të ketë një strategji të qartë lidhur me hapat që po bëhen për të çuar më tej partneritete me institucione të huaja akademike për të arritur në ndërtimin e programeve që mund të rezultojnë në joint apo double-degree. Projektet e ofruara nga programet specifike siç janë Erasmus+ janë një hap i ndërmjetëm në këtë drejtim.
2. Duhet një angazhim më i madh për të rritur mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve duke marrë pjesë në programe të dedikuara për këtë qëllim si Erasmus+ ku mirëpritet angazhimi i universiteteve nga Ballkani përëndimor në veçanti.
3. Një shpërndarje më harmonike e lëndëve ndërmjet dy viteve të programit mund të arrihet duke transferuar disa module nga viti i parë në të dytë dhe anasjelltas, kalimi i një pjese të modulit në nivelin Bachelor apo edhe integrimi i disa komponentëve të rinj, veçanërisht duke mbajtur parasysh procesin e integritimit evropian.
4. Duhet një kujdes dhe vëmendje më e madhe në krijimin e brezit të ndërmjetëm akademik ndërmjet Profesorëve dhe Dr/PhD (veçanërisht për PAE).
5. Duhet të rishikohet më mirë përputhshmëria e profilit akademik të pedagogëve me lëndët që mbulojnë dhe ofrimi i këtyre lëndëve nga pedagogët me profilin përkatës.
6. Duhet të stimulohen publikimet e pedagogëve PAE si duke i vendosur ato në kriteret e vlerësimit ashtu edhe duke ndihmuar kur është e mundshme me lehtësimin e ngarkesës mësimore për ti dedikuar më shumë kohë publikimeve (ndonëse ngarkesa mësimore është në nivele mjaft të pranueshme në krahasim me ngarkesën e ofruar nga dispozitat ligjore).
7. Duhet të institucionalizohen modele bashkëpunimi me institucione publike dhe private lidhur me kriteret e praktikave mësimore, si edhe një specifikim konkret i kushteve që duhet të plotësojnë si studentët ashtu edhe institucionet gjatë kësaj periudhe.

III. EEG CONCLUDING SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats) ANALYSIS

a. Strengths:

1. The institution has been adequately addressing the major part of recommendations put forward by the previous accreditation, offering the opportunity to improve the expected results of the University and of the master programme.
2. The university provides programmes, which are compatible with its mission and its short-mid-term development strategies as well as has set in place a periodical procedure concerning the evaluation and improvement of the didactic programme.
3. Non-academic structures and admin staff offer a positive support on enhancing the processes of teaching and scientific research.
4. The Master programme offers a wide-range of methodologies related to the evaluation of students.
5. A harmonized involvement of PAE and PAK concerning both their workload and the variety of covered academic topics.

b. Weaknesses:

1. Limited efforts dedicated to the process of the programme internationalization, to the participation of the academic staff in international projects as well as to the development of joint initiatives/programmes with the European universities.
2. More efforts can be devoted to increase the mobility of students and the academic staff. There are only three students (at the university level), who have been participating in a mobility programme, while there is no available information concerning the performance of the academic staff in this indicator.
3. Insufficient inter-disciplinary approach implemented in curriculum of the programme, while the later could be more balanced by re-allocating more courses of type A in the first year and courses of type B in the second year of the Master.
4. Some lecturers are in charge of courses (for instance the International Relations), which are compatible neither with their academic background nor with the topics of their publications.
5. The publications presented by the academic staff of the programme are below the satisfactory level concerning the quantity (there are few publications during the period from the last accreditation) and quality (it is not clear from the provided information whether any of the articles is published by impact-factor journals).
6. There is an age-discrepancy concerning the academic titles especially for PAE. Moreover, there is an eminent need to increase the level of academic of titles among PAE, although the legal requirements are accordingly meet.
7. There is a limited number of cooperation agreements with public and private institutions, where is clearly stated the opportunity to conduct internships and the methodologies to follow students' performance in this type of activities.
8. There is no proper study on the labour market where are stated the market needs for professionals with skills offered by the programme. Although, it's an endeavour to identify hard-data in this respect, proxy-indicators can be employed to identify the needs of the labour market. There is no specific study dedicated to the academic programmes offered by other universities in this area, so to realize the unique selling proposition for the students graduated by this programme. It needs to be clearly explained which are the attributes and advantages that have students completing this programme, so to increase their competitiveness in the labour market (compared to their student-mates who complete their study in another academic programme).

c. Opportunities:

1. Identify the strategies to appropriately meet the standards and indicators listed in the RVJ since by doing so they will improve the overall performance of the academic programme.
2. Revise the curriculum, considering the needs presented by the Albanian companies and public institutions, especially when keeping in mind the European integration process.
3. Increasing the number and quality of publications from PAE, particularly on the topics related to this master programme.



4. Exploit more appropriately the already signed agreements and established contacts to sign agreements focused on academic cooperation, exchange of students and academic staff as well as on the students' internship.

d. Threats:

1. A limited labour market calling for specific skills.
2. The process of internationalization is time-consuming, while the limited number of Albanian HEIs participating in international initiatives doesn't enhance the process.
3. The limited experience of the Albanian companies and public institutions in interacting with students, during their internship.

Recommendations:

